

Deskoska
Amnisti për
"27 Prillin" nuk
guxon të ketë

Fq.4



**"ATO" NIS
ME PUNË**
ATO nuk
do të prodhojë
"bomba"

Fq.4



Të
vazhdojmë
me këtë
ritëm

Osmani

Fq.19



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3499 · e premte, 2 nëntor 2018

12°C | 22°C

15 DEN



KOHA për
InfraRed

Fq.12-15

EDITORIAL

Lëvozhgat
e pashkoqura
të rrugaçërisë
parapolitike



Gjuha e politikanëve (shumicës prej tyre) nuk dallon shumë nga ajo e rrugës. Nëpër studio televizive, në foltore të Parlamentit dhe në panele të ndryshme, politikanët e tregojnë vet se sa të pakulturuar janë... Fq.2

RAJON

Pangalos për
Kaçifas: Duhej
vrrarë sepse
kishte armë

Fq.16

GLOBI

Universitetet
amerikane
morën
350 milionë
dollarë nga
Qeveria
saudite

Fq.17



DOBËT ME BIZNES

ASNJË KOMUNË SHQIPTARE NË TOP 10



Asnjë komunë më shumicë shqiptare nuk renditet në top dhjetëshin e komunave me bizneset më të fuqishme në shtet që qarkullojnë më shumë para dhe punësojnë një numër të madh të punëtorëve. Ekspertët ekonomik nuk çuditen me këto të dhëna, pasi siç thonë ata, kjo vjen si rrjedhojë e mungesës së investimeve njësoj në të gjithë shtetin

Fq.6

VMRO, rekordmene - 9 parti dolën nga ajo

Shkup, 1 nëntor - Zgjedhjet e para parlamentare të mbajtura në vitin 1991 në Maqedoni i fitoi partia VMRO-DPPME nën udhëheqjen e kryetarit Ljubčo Georgievski dhe në Parlamentin e parë të Maqedonisë u ulën gjithsejtë 38 deputetë. Themeluesit e kësaj partie që në fillim të pavarësisë të Maqedonisë, dhe si parti që formoi qeverinë e parë të Maqedonisë, si prioritet kishin nënçmimin dhe diskriminimin e shqip-

tarëve të Maqedonisë. Ende e freskët është deklarata e nënkryetarit të kësaj partie VMRO-DPMNE, Vladimir Golubovski i cili menjëherë pas zgjedhjeve dhe formimit të qeverisë në konferencën e parë publike u bëri thirrje shqiptarëve që t'ju hipin trenave dhe të shkojnë në Shqipëri se janë të padëshirueshëm të vazhdojnë të jetojnë në Maqedoni. Që nga kjo kohë filluan dhe përçarjet e para në... Fq.3



EDITORIAL

LËVOZHGA E PASHKOQURA TË RRUGAÇËRISË PARAPOLITIKE



Emin AZEMI

Gjuha e politikanëve (shumicës prej tyre) nuk dallon shumë nga ajo e rrugës. Nëpër studio televizive, në foltore të Parlemnit dhe në panele të ndryshme, politikanët e tregojnë vet se sa të pakulturuar janë. Ka mjaftuar një debat në KTV, por edhe një seancë plenare të Parlemnit të Kosovës, ditën e mërkurë, për tu bindur se politikanët, dinë gjithçka tjetër, vetëm të debatojnë për tema konkrete nuk dinë. Ata dinë të shahen me një listë të gjatë arsenalësh banale, të ofendohen dhe madje edhe të kacafyten, por jo edhe të jenë zëdhënës të halleve të atyre që i kanë votuar.

Kultura politike nuk mund të jetë e veçuar nga profili i formimit të një personaliteti. Ngjashëm si me një shofer, i cili sillet në trafik, ashtu siç është edhe në jetën e përditshme. Politikani-njeri dhe politikani-shofer nxjerr për në fund një simbiozë të çudisthme të një gjysëm-njeriu, të cilit i ka munguar ajo sasia e aditivit evolutiv në jetë-formimin e tij dhe nuk është për t'u habitur që një ditë punimet e parlamenteve tona do të ndiqen të dhoqëruar me një pulë të kuqe, si mekanizëm që mbron fëmijët dhe adoleshentët nga lëvozhga e pashkoqur e rrugaçërisë parapolitike.

Përgjegjësia ndaj publikut është zero. Debatuesit harrojnë se ata ndiqen nga një audiencë e gjerë dhe fjala e tyre ka peshë. Ata nuk kanë turp për atë që e thonë dhe nuk kanë keqardhje ndaj atyre që i dëgjojnë. Ata harrojnë se fjalët dhe sjelljet e tyre ndiqen nga familjarët e oponentëve, kurse dhuna verbale që ushtrorin ndaj njëri tjetrit, është një traumë e papërshkruar për fëmijët që janë të detyruar të ndjekin në televizor prindërit e hutuar nga pasioni i tiranisë së fjalëve të rënda. Një fëmi që dëgjon për babain e tij lloj lloj kualifikimesh ofenduese, rritet bashkë me hijen e urrejtjes që e ndjek në çdo hap të jetës. Nesër do të kemi aq shumë hije urrejtjeje, sa që nuk do të mund të shikojmë njeri tjetrin, nuk do të mund të zgjidhim problemet që mund të quhen të përbashkëta.

Politikanët tanë (me pak përjashtime) po e instalojnë një shkollë të mbrapsht edukimi për brezat e rinjë dhe është për të ardhur keq që ata vazhdojnë edhe më tej të presin mbështetje elektorale për rrugaçërinë e tyre të radhës në mandatet në vazhdim.

Dhuna verbale është bërë pjesë e formimit të njeriut-politikan. Në rastin konkret, ajo mund të evitohet vetëm atëherë kur shmangen nga skena politike bartësit e kësaj dhune verbale. Të kontrabandosh besimin e votuesve për të qenë një perhapës i zellshëm i banaliteteve dhe harbutërive në Parlament, në studio televizive e gjetiu, është abuzimi më i madh që mund të bëjë një politikan. Replika e kthyer në sharje e ofendim, që është nus-produkt i një diskutimi të pamatur paraprak, s'është asgjë tjetër pos kompensim më i kollajshëm i mosgatishmëritë për t'u marrë me tema esenciale dhe jetike që prodhion realiteti i vrazhdë.

Një politikë që ka në vetvete përfaqësues të tillë, e ka të garantuar dështimin dhe është "insulinë" e agonisë. Votuesit kot presin ndryshime nga ata që gatishmërinë për t'u grushtuar në mes veti e kanë më të madhë se disponimin politik për të amenduar ndonjë draft ligj që ngrit cilësinë e jetës.

Opozita shqiptare duhet të jetë këmbëngulëse

"Opozita shqiptare në proces duhet të jetë këmbëngulëse për kërkesat para qeverisë, ndërkombëtarëve dhe para vetes.

Nuk mund të cilësohet nacionalizëm gjuha dhe kultura e një etnie tjetër. Vetëm një shovenizëm i ekzagjeruar mund t'i shpallë armiq të gjithë të tjerët që nuk pajtohen me politikën koloniale dhe dominuese njëetnike", ka shkruar një status në Facebook, analisti Selim Ibrahim.



Reformimi i sistemit të përgjimeve

"Keqpërdorimet sistematike në lidhje me përgjimet e paligjshme imponuan nevojën për reformimin e sistemit të përgjimeve në shtet! Sot fillon të funksionojë Agjencia Teknike Operative (ATO) duke eliminuar teknikisht mundësinë e keqpërdorimeve të përgjimeve dhe duke ngritur në shkallë më të lartë respektimin e dinjitetit njerëzor, lirive dhe të drejtave të qytetarit dhe sundimin e së drejtës! Besuam dhe punuam për reformimin e sistemit të përgjimeve në shtet!", ka shkruar një status në Facebook, zv.ministri i Brendshëm Agim Nuhiu.



Ofshamat e dhunës dhe dihamat e kënaqësisë

"Rrahja me grushta është shënjë se Vetëvendosja dhe PSD-ja ende nuk janë ndarë. Pas dhunës pritet të pasojë pajtimi dhe pastaj pëseri të fillojë cikli i dhunës. Dikush në dhunë mund të përjetojë edhe kënaqësi seksuale. Ky që është sipri mund të jetë sadisti, ai që është përfundim mund të jetë mazohisti. Ne nuk kemi nevojë të shqetësohemi përderisa të dy palët ndahen të kënaqur! Homoseksualizmi është i lejuar edhe me Kushtetutën e Kosovës. Me rëndësi është që ofshamat e dhunës dhe dihamat e kënaqësisë të mbesin larg publikut!", ka shkruar në profiling e tij në Facebook, Liri Loshi.



MEDIA Citate

KU ËSHTË KUFIRI MIDIS SERBISË E KOSOVËS

Reporter i televizionit serb, TV Prva, Zhelko Tvrdishi, ka hyrë nga Serbia në territorin e Kosovës bashkë me kameramanin nga pikëkalimi në Leposaviq, por, siç dëgjohej nga videohirimi i transmetuar nga B92, ai "nuk e ka kuptuar" të ketë hyrë në një shtet tjetër.

Thotë se "nuk e di çfarë shkruan në letër, por kur vjen këtu nuk e merr vesh ku është kufiri" midis Serbisë e Kosovës. Reporter i në gjuhën e vet serbe shqipton këtë përmbytje, të përkthyer nga Koha.net.

Ky është vendi Dren në Komunën e Leposaviqit. Deri në vitin 1960 këtu ka qenë vija administrative mes Kosovës dhe Serbisë. Nga fundi i viteve '50-ta në Republikën e Serbisë u mor vendimi që kufiri të zhvendoset nga këtu në Majën e Pançiqit. Nga këtu rreth 15 kilometra është pikëkalimi Jarinjë. Atje janë të stacionuar policët e Kosovës dhe doganierët e Kosovës dhe sipas letrave nga ajo pikë fillon kufiri i Kosovës. Por nëse nga ajo pikë nisemi në drejtim të Mitrovicës, në praktikë është krejtësisht diçka tjetër. Këtu valëviten flamujt serbë trengjyresh dhe kudo flitet gjuha serbe. Në këtë territor monedha me të cilën bëhet tregti është vetëm dinari serb. Njerëzit shërohen në institucionet shëndetësore serbe. Rinia mëson nëpër shkollat dhe fakultetet që punojnë me programet e sistemit arsimor të Serbisë. Nga Jarinja deri te kjo urë mbi Ibër, që ndan Mitrovicën e Veriut me atë të Jugut, serbët përbëjnë shumicën. Veturat janë me targa serbe dhe me këto regjistrime deri në këtë pikë (te ura e Ibrit) mundesh, por përtej, në jug nuk bën jo vetëm teorikisht, por edhe në praktikë, sepse atje është Republika e Kosovës. Disa prandaj me të drejtë pyesin "Ku është kufiri?".

(B92, 1 nëntor)

NËSE NUK E KENI DITUR...

CIA FLET PËR 16 MIJË SERBË E 800 MIJË SHQIPTARË TË DËBUAR

Gjatë luftës në Kosovë, nga shtëpitë e tyre janë dëbuar 16 mijë serbë dhe 800 mijë shqiptarë. Kështu thotë raporti i CIA-s, sipas dokumenteve të deklasifikuara. Raportet e CIA-s thonë se serbët gjatë luftës nga Kosova kanë ikur nga frika e hakmarrjes për shkak të konflikteve të armatosura, ndërsa shqiptarët për shkak të masakrave dhe dëbimit masiv të tyre nga forcat paramilitare e militare të regjimit të Millosheviqit. CIA po ashtu vlerëson se një numër jo i madh serbësh, romësh, ashkalinjësh ikën gjatë trazirave që ndodhën në Kosovë më 2004.

CIA merret me të gjitha shtetet e botës, ndër të cilat radhit edhe Kosovën, dhe sjell të dhëna të hollësishme mbi rregullimin shtetëror, pozitën gjeografike, numrin e banorëve, klimën, matjen e kohës, personalitetet kryesore politike... E përditshmja e Beogradit, "V. Novosti" i kundërvihet CIA-s dhe flet për "mbi 180 mijë serbë të ikur nga terrori i UÇK-së" dhe shton se "sipas të dhënave të shtetit tonë (e ka fjalën për Serbinë, - sqarim ynë) rreth 200 mijë serbë vite me radhë nuk mund të kthehen në vatrën e tyre (në Kosovë - plotësim ynë)..."

Nga viti 1991 janë përjashtuar funksionarë të lartë dhe deputet të partisë VMRO të cilët më pas kanë formuar parti të reja. Rasti i fundit është formimi i partisë VMRO-Partia Popullore (VMRO-NP) nga kryetari i parë i partisë VMRO-DPMNE, Ljubčo Georgievski. Së shpejti pritet dhe formimi i partisë së re, po ashtu VMRO-Reformuese, nga 8 deputetët e përjashtuar dhe disa funksionarë të lartë të ish partisë së Gruevskit, për shkak se i votuan ndryshimet kushtetuese për ndryshimin e emrit të Maqedonisë

HISTORIA E PËRÇARJEVE MAQEDONASE

VMRO REKORDMENE, 9 PARTI DOLËN NGA AJO



Mirëpo si duket përçarjet në partinë e VMRO-DPMNE nuk kanë të ndaluar sidomos pas përjashtimit nga partia, së pari të 8 deputetëve të cilët në Parlament votuan ndryshimet kushtetuese që kanë për qëllim ndryshimin e emrit të Maqedonisë dhe anëtarësimin në BE dhe NATO me emrin e ri Maqedonia Veriore. Më pas nga partia VMRO - DPMNE u përjashtuan funksionarë të lartë të kësaj partie si Mitko Jançev, Sasho Mijallkov dhe Nikolla Todorov. Përvoja e deri tanishme ka treguar se funksionarë të lartë të kësaj partie dhe deputetë që përjashtohen kanë formuar parti të re, duke i mbajtur si trashëgimi katër shkronjat e para VMRO. Kështu 8 deputetët që ditë më parë u përjashtuan nga partia VMRO-DPMNE në Parlamentin e Maqedonisë, tash e tutje do të veprojnë si grup i pavarur parlamentar me koordinatorë, Elizabeta Kançevska Millevska, deputete njëherit dhe ish ministre në Qeverinë e Nikolla Gruevskit. Thuhet se së shpejti ky grup parlamentar do të dorëzojë në Regjistrin Qendror iniciativën për formimin e partisë së re, e cila po ashtu do të ketë katër shkronjat e para VMRO, ndërsa i shtohet vetëm emri reformatore apo VMRO-Reformuese dhe me siguri se me këtë emër do të garojë në zgjedhjet e ardhshme parlamentare, me listë të vete deputetësh.

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 1 nëntor - Zgjedhjet e para parlamentare të mbajtura në vitin 1991 në Maqedoni i fitoi partia VMRO-DPMNE nën udhëheqjen e kryetarit Ljubčo Georgievski dhe në Parlamentin e parë të Maqedonisë u ulën gjithsej 38 deputetë. Themeluesit e kësaj partie që në fillim të pavarësisë të Maqedonisë, dhe si parti që formoi qeverinë e parë të Maqedonisë, si prioritet kishin nënçmimin dhe diskriminimin e shqiptarëve të Maqedonisë. Ende e freskët është deklarata e nënkryetarit të kësaj partie VMRO-DPMNE, Vladimir Golubovski i cili menjëherë pas zgjedhjeve dhe formimit të qeverisë në konferencën e parë publike u bëri thirrje shqiptarëve që t'ju hipin trenave dhe të shkojnë në Shqipëri se janë të padëshirueshëm të vazhdojnë të jetojnë në Maqedoni.

Që nga kjo kohë filluan dhe përçarjet e para në partinë VMRO-DPMNE. Partia e parë që u nda ish-

te shume më herët dhe at në vitin 1990 dhe i mbajti katër germa e para VMRO duke i shtuar pas Ilinden apo VMRO-Ilinden. Më pas për shkak të mosmarrëveshjeve dhe përçarjeve mes anëtarëve të partisë më kryesinë e VMRO-DPMNE, nënkryetari i partisë së asaj kohë Vladimir Golubovski jep dorëheqje si funksionar i lartë dhe formon partinë e re VMRO-Partia Demokratike (VMRO-DP). Më vonë për shkak të mospajtimeve me kryetarin e partisë Ljubčo Georgievski, Boris Stojmenov, si deputet i VMRO-DPMNE në vitin 1994, formoi partinë e re VMRO-Maqedonase dhe garon në zgjedhjet e dyta parlamentare të rregullta në vitin 1994 me listë të vetme deputetësh. Më pas formohen edhe disa

parti tjera që kanë mbajtur katër shkronjat e para VMRO.

Nga viti 1994 e deri në vitin 2002 u formuan VMRO- Opsioni i Vërtet për Reforma në Maqedoni (VMRO-VMRO), VMRO - Goce Delçev - Partia Radikale Demokratike (VMRO-GD-RDP), VMRO - Lëvizja për Rindërtimin e Maqedonisë (VMRO-DOM), VMRO-e Bashkuar (VMRO-OBEDINETA) të cilat pothuaj se kanë marrë pjesë të ndara nga VMRO-DPMNE, në zgjedhjet parlamentare të mbajtura nga viti 1994 e deri në vitin 2002.

Mirëpo historia e përçarjes brenda partisë VMRO-DPMNE nuk përfundon me kaq. Përçarja më e madhe e partisë VMRO-DPMNE ka ndodhur në vitin 2002 për

shkak të mosmarrëveshjeve dhe grindjes që ndodhi midis kryetarit të atëhershëm të VMRO-DPMNE-së Ljubčo Georgievski dhe Nikolla Gruevski, ministër në kabinetin e Qeverisë së Georgievskit. Kryesia dhe një numër i madh i anëtarëve të VMRO-DPMNE të pakënaqur atëbotë me politikën udhëheqëse të Georgievski dhe humbjen që pësoi nga LSDM-ja në zgjedhjet e paralamentare në vitin 2002, kërkuar dorëheqjen e tij dhe besimin ia dhanë Nikolla Gruevskit i cili në krye të partisë qëndroi deri në fund të vitit 2016. Edhe përkundër faktit se u zgjodh Ljubčo Georgievski kryetar nderi i VMRO-DPMNE ai formoi parti të re me emrin VMRO-Partia Popullore (VMRO-NP).

Ngrihet prona e VMRO-DPMNE-së

Shkup, 1 nëntor - Me kërkesë të kësaj Prokurorie Publike, gjykatësi i procedurës paraprake të Gjykatës Themelore Shkup 1 solli vendim me të cilin është shqiptuar masa e përkohshme për sigurimin e pronës së partisë politike VMRO-DPMNE, kumtoi Prokuroria Publike Speciale. Me masën janë ngrirë gjithsej 69 patundshmëri, në mesin e të cilave edhe objekti në të cilin ndodhet selia e partisë. "Me këtë masë ndalohet tjetërsimi i pronës konkrete si edhe dhënia me qira e së njëjtës. Veprimet janë ndër-marrë në kuadër të lëndës "Talir", duke e pasur parasysh atë që ekziston mundësia e njëjta të tjetërsohet deri në fund të procedurës", thonë nga PPS. Hetimi për "Talir" ka të bëjë me financimin e paligjshëm të VMRO-DPMNE-së nga viti 2009 deri në fund të vitit 2015, ndërsa ekziston dyshim për 4,9 milionë euro të keqpërdorura. Në hetim dyshohen 14 persona, ndërsa në mesin e tyre është edhe lideri i mëparshëm i VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski. Pjesë e hetimit është ndërtimi i selisë kryesore të partisë në Shkup nga kompania ndërtimore Beton.

JANÇEV KUNDËR LIDERIT TË VMRO-së

Synohet shkarkimi i Mickoskit

Shkup, 1 nëntor - Ish-nënkryetari i VMRO-DPMNE-së dhe kryetar aktual i Komunës së Kavadarit, Mitko Jançev, deklaroi se ka potenciale për ndërrimin e liderit të partisë opozitare Hristian Mickoski. Nuk e përjashton mundësinë të kandidohet për lider partie nëse ka kongres të ardhshëm dhe nëse formon ekip me të cilin do të menaxhonte mirë.

"Nga pikëpamja ime, në parti nuk është se po shkëlqejnë punët. Mendimi im personal është se në VMRO-DPMNE nuk ekziston njeri i cili do të bënte puç. Përkundrazi, VMRO-DPMNE apo unë atë do ta kërkonim në mënyrë transparente dhe në mënyrë të hapur nga Mickoski. Ka potenciale për ndërrim, për të cilët mund ta ofrojnë programin e tyre, por nuk ka njeri që do ta bënte atë pas shpine. Unë mendoj se Mickoski duhet t'i përgjigjet letrës së Mijallkovit. Unë po të

isha lider, do t'u përgjigjesha të gjitha pyetjeve", tha Jançev në intervistën në "Vetëm e vërteta" në TV Kanal 5.

I pyetur nëse e sheh veten si lider të ardhshëm të VMRO-DPMNE-së, Jançev u përgjigj se nëse ka kongres të ardhshëm dhe formon ekip me të cilin do të menaxhonte mirë dhe nëse bën një statut më liberal dhe më demokratik dhe ofron program të mirë i cili do t'i kënaqte kërkesat e një pjese më të madhe të anëtarësisë, ai do të kandidohej për njeri të parë të partisë. Nuk pret të tërhiqet shkarkimi i tij dhe të kthehet në pozitën e nënkryetarit në VMRO-DPMNE. Jançev përgënjeshtroi se ka marrë pjesë në çfarëdo bindjesh apo presionesh ndaj deputetëve që të votojnë për qasje ndaj ndryshimeve të Kushtetutës, në pajtim me Marrëveshjen e Prespës.

"Jo, nga aspekti im personal nuk ka



pasur kurrfarë bindjesh, kurrfarë presionesh, kurrfarë kontakti, nëse ekziston një gjë e tillë unë nuk kam marrë pjesë", tha Jançev. Për dorëheqjen e fundit në parti, thotë se nuk beson se njerëz si Daniela Rangellova dhe Luka Kërzhallovski punojnë sipas ndonjë direktive.

DESKOSKA E PRERË PËR NATËN E PËRGJAKSHMENË PARLAMENT

AMNISTI PËR “27 PRILLIN” NUK GUXON TË KETË



Amnisti për dhunën në Parlament të 27 prillit të vitit të kaluar nuk guxon të ketë, për arsye se, siç tha ministrja Deskoska, bëhet fjalë për ngjarje që u ka lënë jo vetëm traumë personale njerëzve por edhe traumë mbi tek e gjithë shoqëria

Ohër, 1 tetor - Amnisti për dhunën në Parlament të 27 prillit të vitit të kaluar nuk guxon të ketë, deklaroi ministrja e Drejtësisë, Renata Deskoska në Ohër ku mori pjesë në punëtorinë kushtuar reformave në sistemin juridik. Lidhur me deklaratën e kryeministrit Zoran Zaev për pajtim në Parlament, Deskoska tha se ky është qëndrim i cili duhet të mbështetet, të bisedohet në kontekstin më të gjerë, por se amnisti për dhunën në Parlament të 27 prillit të vitit të kaluar nuk guxon të ketë, për arsye se, sipas saj, bëhet fjalë për ngjarje që u ka lënë jo vetëm traumë personale njerëzve por edhe traumë mbi tek e gjithë shoqëria.

“Ne në kuadër të agjendës reformuese duhet të tregojmë gatishmëri si shtet të procesojmë dhe të vijmë deri në shkallën e përgjegjësisë për rastet të cilat i udhëheq PPS, si edhe për ngjarjet e 27 prillit”, theksoi Deskoska. Për pajtimin, ajo tha se ky do të ishte një proces i bisedimeve, përmes formimit të trupit në Parlament, përbërja e së cilit akoma nuk është përkufizuar as në momentin nuk është e njohur se si do të formohet kjo.

“Këtu duhet të zbatohen kon-

sultime midis partive politike që janë në Parlament, të bisedojnë për çështje të caktuara. Të gjithë jemi të vetëdijshëm se ajo që ishte praktikë e keqe në të kaluarën të cilën e kanë ndjerë deputetët dhe funksionarët e LSDM-së kur u soll ligji për gjuhët, paraprakisht me ato presione, kanosje personale, tani ato u ndodhin deputetëve të cilët kanë pasur guxim të votojnë për ndryshime kushtetuese. Kjo është praktikë e cila duhet të ndërpritet. Këtu do të përfshihen edhe organet, por

ka nevojë edhe për diskutime në nivel politik që atje që të gjithë e kanë të qartë se ata të cilët kanë bënë nekrologji për deputetët e LSDM-së, tani u kanosen deputetëve të cilët ishin për ndryshime kushtetuese, nuk janë individë. Ka indikacione serioze se ky është aksion i organizuar”, tha Deskoska, duke nënvizuar se është duke u krijuar klimë e keqe, problem për të cilin duhet të bisedohet në kontekst më të gjerë, jo vetëm në nivel të organeve.

NDRYSHIMET KUSHTETUESE GARANTOJNË IDENTITETIN MAQEDONAS

Në tekstin normativ të ndryshimeve kushtetuese do të vihet garancë në identitetin e popullit të Maqedonisë, përkatësisht tre bazat që e determinojnë identitetin, e ato janë kultura, trashëgimia historike dhe gjuha. Këtë e theksoi ministrja e Drejtësisë, Renata Deskoska, në Ohër, në punën e Punëtorisë kushtuar reformave në sistemin e jurisprudencës. “Qeveria ka afat deri nesër t’i parashtojë projekt-amendamentet në Parlament për ndryshimet kushtetuese. Janë bërë konsultime me tetë deputetët e opozitës të cilët i mbështetën ndryshimet kushtetuese, u arrit futja e

dispozitës që do ta garantojë identitetin e popullit maqedonas. Sugjerimi ynë për të cilin arritëm marrëveshje të përbashkët ishte ajo të jetë në kuadër të tekstit normativ, ku në një nga nenet të cilat do të ndryshohen do të vihet garanca e identitetit të popullit maqedonas. Ai do të jetë formulimi që ka të bëjë me kulturën, trashëgiminë historike dhe gjuhën. Ne tashmë kemi dispozitë e cila ka të bëjë me gjuhën, do të thotë vihet dispozita që do të garantojë mbrojtje dhe zhvillim të trashëgimisë kulturore dhe historisë së popullit maqedonas”, tha Deskoska.

Blllokohen pronat e VMRO-DPMNE-së


Shkup, 1 nëntor - Me kërkesë të Prokurorisë Speciale Publike, gjykatësi i procedurës paraprake të Gjykatës Themelore Shkup 1, solli vendim me të cilin është shqiptuar masa e përkohshme për sigurimin e pronës së partisë politike VMRO-DPMNE, kumtoi Prokuroria Publike Speciale.

Me masën janë ngrirë gjithsej 69 patundshmëri, në mesin e të cilave edhe objekti në të cilin

ndodhet selia e partisë.

“Me këtë masë ndalohet tjetërsimi i pronës konkrete si edhe dhënia me qira e së njëjtës. Veprimet janë ndërmarrë në kuadër të lëndës “Talir”, duke e pasur parasysh atë që ekziston mundësia e njëjta të tjetërsohet deri në fund të procedurës”, thonë nga PPS.

Hetimi për “Talir” ka të bëjë me financimin e paligjshëm të VMRO-DPMNE-së nga viti 2009 deri në



fund të vitit 2015, ndërsa ekziston dyshim për 4,9 milionë euro të keqpërdorura.

Në hetim dyshohen 14 persona, ndërsa në mesin e tyre është edhe

lideri i mëparshëm i VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski. Pjesë e hetimit është ndërtimi i selisë kryesore të partisë në Shkup nga kompania ndërtimore Beton.

Të sigurt deputetët e kërcënuar

Shkup, 1 nëntor - Të gjithë për të cilët kemi informacione dhe për të cilët ka kërcënime serioze, kemi bërë vlerësim, janë siguruar, u përgjigj ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski në pyetjen e gazetarëve nëse sigurohen deputetët dhe konkretisht kryetari i Kavadarit, Mitko Jançev, i cili denoncoi kërcënime ndaj familjes së tij. “Kryetari Mitko Jançev denoncoi se kërcënohet. Niveli i kërcënimit të tij është patrullues. MPB-ja qëndron në dispozicion të secilit që kërcënohet të sigurojë mbrojtje përkatëse”, tha Spasovski, ndërsa përkujtoi se edhe Hristijan Mickovski ka marrë kërcënime dhe i janë dhënë shërbime të sigurisë si kryetar i opozitës.

“Tenderët” shtyhet për më 9 nëntor

Shkup, 1 nëntor - Për shkak mungesës të kryetarit të këshillit gjyqësor Osman Shabani, seanca për lëndën “Tenderët” e Prokurorisë Speciale Publike është shtyrë për më 9 nëntor të vitit 2018. Në gjykimin e ardhshëm duhet të dëgjohen dy dëshmitarë. Kançeska-Milevska është e akuzuar për keqpërdorime me tenderin për realizim të punimeve ndërtimore në Muzeun e VMRO-së, nga projekti “Shkupi 2014”. Sipas aktakuzës një pjesë e punëve ndërtimore në Muze janë kryer në dobi të personit juridik “Beton” nga Shtipi. Para se të publikohet shpallja për ndarje të marrëveshjes për furnizim publik dhe para se të zbatohet procedura, në kundërshtim me Ligjin për furnizime publike, Kançeska-Milevska përmes bisedimeve me drejtorin e përgjithshëm të punëve ndërtimore të kompanisë ndërtimore “Beton” nga Shtipi ka urdhëruar që të vazhdohet me punën në Muze, kur janë kryer punë ndërtimore sipas marrëveshjes së lidhur paraprakisht për furnizim publik.

SKANDALET ME PËRGJIMET I TAKOJNË TË KALUARËS

"ATO" NUK DO TË PRODHOJË "BOMBA"

Mbase një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të DSK-së, gjatë periudhës së kaluar ishin të përfolur si pjesë skandalit të "bombave", drejtori Angellovski në konferencën e parë për shtyp, tha se për marrjen e personelit të theksuar nga MPB ai e kishte konsultuar edhe Prokurorinë Speciale Publike



Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 1 nëntor - Skandali me "bombat" që e tronditi Maqedoninë, nuk do të përsëritet asnjëherë më. Kështu të enjten u shpreh drejtori i ri i Agjencionit Tekniko Operativ, Zoran Angellovski, i cili në ditën e parë të punës së këtij institucioni të ri të sigurisë, theksoi se për momentin të gjitha përcjelljet e komunikimeve zhvillohet në bazë të normave ligjore. Përmes transformimit të pajisjeve për përgjime nga DSK-ja, te ATO, siç është potencuar deri më tani nga Qeveria synohet parandalimi i keqpërdorimit të pajisjeve për përgjime, të cilët në 27 vitet e kaluara të ekzistimit të Maqedonisë shpesh herë kanë krijuar kriza të renda politike në vend.

"ATO është agjenci profesionale dhe një trup plotësisht i pavarur. Për momentin funksionon me kuadër teknik të marrë nga DSK, gjegjësisht një pjesë e kuadrit deri në hapjen e konkursin të ri për pranimit të të punësuarve është marrë nga Byroja për Siguri Publike (katër persona), dhe tre të punësuar nga Drejtori për Siguri dhe Kundërzbulim. Gjatë muajve që vijojnë besoj se do të shtymë me këtë kapacitet. Realisht nuk besoj se deri në janar do të hapet konkurs për pranimitin e të punësuarve tjerë, që sipas sistematizimit të kryer ATO prite të numëroj 25 të punë-

suar", tha drejtori i ri i ATO-së, Zoran Angellovski.

Mbase një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të DSK-së, gjatë periudhës së kaluar ishin të përfolur si pjesë skandalit të "bombave", drejtori Angellovski në konferencën e parë për shtyp, tha se për marrjen e personelit të theksuar nga MPB ai e kishte konsultuar edhe Prokurorinë Speciale Publike. Nga ana tjetër, shefi i parë i policisë së shtetit, Oliver Spasovski, deklaroi se kontrolli për ATO-në do të jetë në shumë nivele, duke filluar nga Komisioni Parlamentar, sektori civil dhe nga ekspertët.

"Vërejtjet kyçe të theksuara në raportin e Pribes u mënjantuan. Ne si MPB, gjegjësisht Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim nuk ka qasje direkte deri te pajisjet për përcjelljen e komunikimeve. Njëkohësisht këto institucione të sigurisë po ashtu nuk dinë dhe nuk kanë të dhëna për zbatimin e Masave të Posaçme Hetuese, të cilët janë kërkuar nga organet tjera të autorizuara për përcjelljen e komunikimeve. Ndryshe, MPB (DSK) nuk ka qasje të përmbajtja e atyre komunikimeve të përcjellja, me përjashtim të atyre masave që janë me kërkesë të DSK, për të cilën paraprakisht janë është siguruar leje nga gjykata", tha ministri i policisë, Spasovski.

Në të kaluarën sipas Spasovskit, shumë është folur për këtë çështje, me çka shteti i

Maqedonisë për shkak të keqpërdorimit të këtyre komunikimeve, brenda një periudhe të shkurtë pranoi raporte të ndryshme negative për dobësitë e detektuara në sistemin e kaluara, të cilën shkaktuan probleme të mëdha dhe krizë serioze politike në vend.

Ndryshe, skandali i parë i përgjimeve që e ka përfshirë Maqedoninë është regjistruar në vitin 2000, i njohur për opinionin si "Gollemoto Uvo", i cili u zbulua nga lideri i atëhershëm i opozitës së LSDM-së, Branko Cërvenkovski. Si e akuzuar e parë për këtë skandal atëherë u akuzua Ministria e Punëve të Brendshme, Dosta Dimovska, megjithatë ajo dhe disa të akuzuar tjerë u amnistuan më vonë nga kryetari i shtetit, Boris Trajkovski. Kësisoj gati dy dekada më vonë, po ashtu lideri i opozitës, kësaj radhe kryetari i LSDM-së, Zoran Zaev, në shkurt të vitit 2015 e publikoi skandalin e përgjimit të jashtëligjshëm të mbi 20 mijë qytetarëve. Për dallim nga hera e parë, "bombat" e Zaevit, pas themelimit të Prokurorisë Speciale Publike, një kohë të gjatë po shqyrtohet nga Gjykata Penale e Shkupit, e cila mes tjerash skandalin e theksuar e procedon rastin "Target-Fortesa", ku si te akuzuar kryesor hetohen ish shefi i DSK-së, Sasho Mijallkov dhe ish Ministria e Punëve të Brendshme, Gordana Jankullovska.

Shkup, 12 aksidente me 5 të lënduar

Shkup, 1 nëntor - Pesë persona kanë marrë lëndime të lehta trupore në gjithsej 12 aksidente të cilat kanë ndodhur në rajonin e Qytetit të Shkupit. Në shtatë prej aksidentëve është regjistruar vetëm dëm material. Sipas raportit të policisë të SPB Shkup, 21 shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se shpejtësia e lejuar, 18 shoferë janë përjashtuar nga komunikacioni, prej të cilëve 14 pa e marrë të drejtën e lejes për drejtimin e automjetit motorik dhe katër fillestarë. Nga komunikacioni policia i ka përjashtuar dy automjete të cilët kanë qenë me defekte teknike dhe 14 automjete pasi nuk kanë qenë të regjistruara. Në mënyrë të parregullt janë parkuar 110 automjete, ndërsa shërbimi i karrotrecit i ka larguar 62 automjete. Policia i ka sanksionuar katër shoferë të cilët kanë kaluar udhëkryqin në semafor të kuq dhe një shofer i cili është rreshtuar në mënyrë jo të drejtë.

Vrasja në Kumanovë, arrestohen nëntë persona

Shkup, 1 nëntor - Prokurorë nga Prokuroria Themelore Publike dhe ekipe të ekspertizës nga Ministria e Punëve të Brendshme kanë kryer ekspertizë në vendin e ngjarjes në Kumanovë, ku mbrëmë, ndodhi një shkëmbim zjarri mes dy familjeve, me ç'rast jetën e humbi një person - Vebi Maksuti.

Nëntë persona që kanë marrë pjesë në shkëmbim-zjarrin janë privuar nga liria. Ekziston dyshimi se në kryerjen e veprës penale kanë marrë pjesë edhe disa persona. Në drejtim të konfirmimit të fakteve për lëndën, prokurori publik në vazh-

dimësi po ndërmerr veprime. Nga Prokuroria Publike thonë se shkëmbim zjarri ka qenë eskalim i mosmarrëveshjeve dhe mosdurimit disa mujor mes dy familjeve, familjes Maksuti dhe Latifi. Debatet e tyre, si dhe rrahja paraprake me lëndime trupore tashmë kanë qenë temë e veprimit të organeve të policisë.

Me urdhër të prokurorit, në vendin e ngjarjes janë siguruar gjurmë, armë e ftohtë dhe katër gëzhoja plumbash, ndërsa trupi i të ndjerit Vebi Maksuti i është nënshtruar autopsisë.

KRONIKË**Në Shutkë tetovari që u kap me 46 kg marihuanë**

Gjykatësi në procedurën paraprake nga Gjykata themelore në Tetovë i caktoi paraburgim prej 30 ditëve tetovarit N.I. (54), i dyshuar për "prodhim të paautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike, substancave subtropike dhe prekursorëve". Siç informoi zëdhënësi i SPB Tetovë, Marjan Josifovski, menjëherë pas përcaktimit të masës, mbrëmë, pak pas orës 22:00, N.I. është dërguar në ENP Shkup në Shuto Orizarë në paraburgim. Gjatë bastisjes së objekteve në dy vende në Tetovë, pronë e N.I., të kryer të martën, policia gjeti gjithsej 46 kilogramë marihuanë, 13 litra materie të lëngshme, deri më tani të panjohur, vagë digjitale dhe disa mjete që janë dokumentuar me fotografi dhe kamerë dhe janë marrë për ekspertizë. Sipas deklaratës së tij, N.I. marihuanën e ka marrë nga një person nga Shqipëria.

24-vjeçari kapet me marihuanë

Pjesëtarët e policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, Stacioni policor në Gostivar, të mërkurën mbrëma rreth orës 19.00 e kanë privuar nga liria 24 vjeçarin A.S. nga Gostivari, dhe 28 vjeçar Z.Z. nga fshati Sërmnovë. Gjatë kontrollit të kryer ndaj tyre është gjetur marihuanë, e cila është marrë për ekspertizë, derisa dy personat janë mbajtur në Stacionin policor Gostivar për procedurë të mëtejshme.

Aksidentohet një këmbësorë

Të mërkurën orës 17.00, në bulevardin "Blagoja Toska" në afërsi të udhëkryqit me rrugën "Lubo Bozhinovski" në Tetovë, vetura e tipit "Golf" me targa të Tetovës, e drejtuar nga 37 vjeçari Z.J. nga Tetova, ka aksidentuar këmbësorin B.H. 29-vjeçar nga Tetova. Këmbësori i lënduar me të njëjtën veturë është dërguar në Spitalin klinik të Tetovës, për dhënien e ndihmës mjekësore. Janë kryer hetimet në vendin e ngjarjes, dhe punohet në përcaktimin e shkakut të aksidentit, rrethanat dhe detajet tjera në veçanti.

Rrahje pasi aksidentohen tetovarët

Të mërkurën mbrëma rreth orës 21 e 30 minuta në udhëkryqin në mes të rrugëve "Strasho Pinxhur" dhe "Nikolla Tesla" në Tetovë ka ndodhur aksident trafiku, në të cilën kanë marrë pjesë dy vetura me targa të Tetovës, veturat e tipit "Opel Astra" dhe "Seat Kordoba" ku 39 vjeçari Z.Z. nga Tetova nga një person i panjohur ka qenë i sulmuar fizikisht, pasi që në vendin e ngjarjes janë grumbulluar më shumë njerëz, dhe më pas me autoambulancë ka qenë i dërguar në Spitalin klinik të Tetovës. Vozitësi i veturës "Seat Kordoba" S.U. 58 vjeçar nga Tetova, është arrestuar në Stacionin policorë Tetovë, për zbardhjen e plotë të rastit. (U.H)

Asnjë komunë më shumicë shqiptare nuk renditet në top dhjetëshin e komunave me bizneset më të fuqishme në shtet që qarkullojnë më shumë para dhe punësojnë një numër të madh të punëtorëve. Ekspertët ekonomik nuk çuditen me këto të dhëna, pasi siç thonë ata, kjo vjen si rrjedhojë e mungesës së investimeve njësoj në të gjithë shtetin

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 1 nëntor - Në top dhjetëshin e komunave me biznese më të fuqishme në shtet e që qarkullojnë më shumë para dhe punësojnë një numër të madh të punëtorëve, nuk figuron asnjë komunë më shumicë shqiptare. Të dhënat statistikore tregojnë se në listën e 100 kompanive më të mëdha në Maqedoni, Komuna e Kavadarit mban vendin e parë me kompani që në vitin e kaluar kanë pasur xhiro prej afër 252 milionë euro. Shkupi nuk përlogarit për shkak se në këtë konkurrencë marrin pjesë komunat që bëjnë pjesë në kryeqytetin e Maqedonisë. Në vendin e dytë me afër 247 milionë euro është Manastiri, ndërsa në vendin e tretë me xhiro prej afër 240 milionë euro është Ilinden.

Njohësit e çështjeve ekonomike thonë se nuk çudit fakti se asnjë komunë shqiptare as përfaqësohet nuk figuron në këtë listë, si rrjedhojë e mungesës së investimeve njësoj në të gjithë shtetin. "Zhvillimi jo i barabartë rajonal i Maqedonisë si në të kaluarën, por edhe aktualisht, është shkaku kryesor i mos-renditjes së asnjë komune shqiptare me shumicë shqiptare në këtë listë. Me fjalë të tjera, si rrjedhojë e mungesës së investimeve më të mëdha, qoftë shtetërore apo të huaja, apo mungesës së kompanive të mëdha që do të punojnë në Maqedoninë Perëndimore, kemi edhe renditjen e rajonit të Pollogut si më të varfrit

DOBËT ME BIZNES

ASNJË KOMUNË SHQIPTARE NË TOP DHJETË



në Maqedoni me 1929 euro të Prodhimit të Brendshëm Bruto si dhe me një papunësi ndër më të lartat në shtet", thotë profesori universitar, Nasir Selimi.

Sipas tij, është koha e fundit, por edhe imperativ i kohës që pushteti t'i kushtojë më shumë kujdes zhvillimit të qëndrueshëm dhe të barabartë të të gjithë rajoneve në Maqedoni.

"Qeveritarët e kanë edhe obligim kushtetues të përkujdesen për zhvillimin e të gjithë vendbanimeve në Maqedoni në mënyrë të barabartë. Andaj është koha e fundit që të mbështeten dhe përkrahen më shumë në aspektin ekonomik, infrastrukturor e kështu me radhë rajonet që ngecin në aspektin ekonomik për shkak se në të kundërtën, këto zona siç është për shembull Pollogu, në të ardhmen do të zbrazen dhe nuk do të ketë më edhe kush të punojë në fabrikat apo bizneset e tjera", thekson Selimi.

Ai thotë se nevojitet ti ofrohet popullatës së kësaj ane së paku shpresë për një ardhme më të mirë duke zbutur sadopak ikjen e madhe të popullatës dhe boshati-

sjen e vendbanimeve të kësaj zone.

Nga ana tjetër, sipas Prodhimit të Brendshëm Bruto, si indikator apo tregues ekonomik që paraqet vlerën me çmimet e tregut të të gjitha të mirave materiale dhe shërbimeve të prodhuara brenda një rajoni apo shteti në një vit, rajoni më i pasur në Maqedoni është ai i Shkupit me 5673 euro për kokë banori, i pasuar nga rajoni i Vardarit me 4371 euro dhe ai Juglindor me 4333 euro.

Rajoni i Pellagonisë është i katërti me 3955 euro, ndërsa ai Lindor me 3689 euro është i pesti. Në tre vendet e fundit renditet rajoni Jugperëndimor me 2906 euro, ai Verilindor me 2462 euro dhe krejt i fundit me 1929 euro është rajoni i Pollogut.

Në ndërkohë, të dhënat tej tregojnë se në Kavadar, biznesi me qarkullim më të madh është kompania vendore e prodhimeve metalike "IGM Trejd" me të ardhura prej 106 milionë euro, e pasuar nga fabrika gjermane "Drekslemajer", me 57 milionë euro e që ka 5500 të punësuar. Fabrika për përpunimin e duhanit "Alajns Uan", si investim

i huaj me 550 të punësuar e hapur në vitin 2011, si dhe kompania lokale e tregtisë me derivatet e naftës "Crna Reka Petroll", me afër 42 milionë euro.

Komuna e Manastirit është selia e katër kompanive që renditen ndër 100 kompanitë me qarkullim më të madh në Maqedoni. Këtu dallohet fabrika gjermane e kabllove të veturave që u hap në vitin 2013 "Kromberg dhe Shubert", me afër 6000 të punësuar. Ajo, në vitin e kaluar ka pasur xhiro prej 151 milionë euro. Në vendin e dytë me afër 38 milionë euro është Qumështorja e privatizuar e Manastirit me 38 milionë euro, pason zinxhiri i farmacive që shtrihen në tërë Maqedoninë "Eurofarm" me 30 milionë euro dhe kombinati bujqësor "Pellagonia", me të ardhura prej 28 milionë euro. Në Komunën e Ilindenit të Shkupit ka selinë fabrika për prodhimin e autobusëve "Van Hull", si investitor nga Holanda e që punëson mbi 800 punëtorë dhe qarkullon 134 milionë euro.

Në këtë komunë vepron edhe "Pekabesko", apo prodhuesi më i

madh vendor i përpunimeve të mishit me qarkullim prej 71 milionë euro dhe me mbi 450 të punësuar, si dhe distributori "NELT" me 215 të punësuar dhe të ardhura prej afër 33 milionë euro.

Ndër komunat që kanë biznese të fuqishme është edhe Komuna e Velesit ku punon zinxhiri i shitoreve me pakicë "Zhito", me të ardhura prej afër 48 milionë euro, fabrika gjermane "Markart" me mbi 500 të punësuar dhe xhiro prej afër 47 milionë euro dhe fabrika vendore "Brako", me të ardhura prej afër 26 milionë euro. Në Prilep, punojnë katër kompani të suksesshme si "Birraria e Prilepit" me të ardhura prej afër 30 milionë euro, fabrika "Vitaminska" me 28 milionë euro, "Kombinati i Mermerit" që u privatizua nga investitorët grek me afër 26 milionë euro dhe investimi amerikan i industrisë automobilistike "Centerm", me afër 25 milionë euro dhe mbi 700 të punësuar, nga 2000 punëtorë që janë paralajmëruar se do të angazhohen pas rrumbullaksimit të investimit total.

Në Vinicë punojnë edhe kompania "Dadi", e tregtisë me naftë dhe prodhimin bravëpunues të prodhimeve të ndryshme nga hekuri me xhiro prej afër 63 milionë euro dhe fabrika e ëmbëlsirave "Makprogres" me afër 29 milionë euro. Në vendin e shtatë është Makedonska Kamenica me xheoret me pronar të huaj "Sasa", me 90 milionë euro dhe 700 të punësuar. Shtipi dhe Radovishi kanë xhiro nga 68 dhe 66 milionë euro. Në vendin e dhjetë me xhiro prej 63 milionë euro është Komuna e Gjevgjelisë ku punon kazinoja dhe hoteli "Prins", si dhe fabrika e "Kontiplast", e themeluar në vitin 1975 dhe e orientuar kryesisht në eksport me gypat plastike.

THIRRJA E DYTË PËR SUBVENCIONET E SHPORETËVE ME PELETA

Shkup, 1 nëntor - Prej dje, të gjithë banorët e Qytetit të Shkupit mund të aplikojnë për subvencione për blerjen e shporetëve me peleta. Qyteti i Shkupit do të kompensojë një pjesë të shpenzimeve gjatë blerjes të shporetit me peleta, deri në 70 për qind, por jo më shumë se 30.000 denarë, duke përfshirë tatimin mbi të ardhurat personale për amvisëri. Afati për aplikim është deri më 30 nëntor

apo deri në harxhimin e mjeteve të parapara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për këtë qëllim. Thirrja publike do të kryhet sipas principit "i pari i ardhur, i pari i shërbyer".

Kërkuesit, duhet të jenë banorë të qytetit të Shkupit, të mos kenë fituar mjete financiare për blerjen e shporetit me peleta nga cilido burim në Republikën e Maqedonisë dhe deri në dorëzimin

e kërkesës të jenë shfrytëzues të shporetit me qymyr, dru, naftë dhe mazut. Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike kanë banorët e qytetit të Shkupit të cilët do të blejnë shporet me peleta për ngrohjen e shtëpive të tyre (objekt banesor) nga dita e publikimit të thirrjes publike deri në ditën e përfundimit të thirrjes dhe të dorëzojnë kërkesë për kompensimin e një pjese të shpenzimeve

për blerjen e shporetit me peleta. Në Thirrjen publike, siç informojnë nga Qyteti i Shkupit, nuk kanë të drejtë të paraqiten banorët (amvisëritë) të cilët në banesë janë të lidhur me ngrohje qendrore të qytetit, pavarësisht nëse e përdorin atë, si dhe banorët (amvisëritë) të cilët kanë objekt banesor në fazë ndërtimi dhe nuk jetojnë në të.

Qyteti i Shkupit sot e publikoi

Thirrjen publike për kompensim të një pjese të shpenzimeve të qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për blerjen e shporetëve me peleta për vitin 2018, faza e dytë. Thirrja publike do të zgjatë 30 ditë kalendarik nga dita e publikimit, 1 nëntor 2018, deri më 30 nëntor 2018 apo deri në harxhimin e mjeteve të parapara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për këtë qëllim.

Kryetari i komunës së Gostivarit Arben Taravari ka premtuar se do të vazhdojë që të punoj me të gjitha kapacitetet edhe në tre vitet e mbetura të mandatit të tij si kryetar i Gostivarit me qëllim që kjo komunë të jetë në top dhjetëshen e komunave më të zhvilluara në vend

Koha

Urim HASIPI

Gostivar, 1 nëntor - Kryetari i komunës së Gostivarit Arben Taravari përpara këshilltarëve të këshillit komunal, kryetarëve të bashkësive lokale të fshatrave që gravitojnë në komunën e Gostivarit dhe disa qytetarëve ka prezantuar punën 1 vjeçare në krye të komunës së Gostivarit ku ka nënvizuar realizimin e shumë projekteve si në infrastrukturë, arsim, kulturë, transparencë, llogaridhënie si dhe realizimin e 80% të buxhetit të komunës. "Një nga sektorët më të suksesshëm në Komunë, falë angazhimit të udhëheqëses dhe ekipit të saj, e të cilit sektor edhe unë si kryetar i kam kushtuar shumë rëndësi, është Sektori i veprimtarive publike. Për arsimin e theksova edhe më parë, ndërsa tani do të shtoja kulturën, rininë, sportin, rekreacionin, mbrojtjen sociale, përmirësimin e cilësisë së jetës të grupeve të marginalizuara dhe personave në nevojë. Këto sfera janë ndoshta ato të cilat më pak komentohen për punën e komunave, por pikërisht ato janë tejet të rëndësishme për qytetarët", tha Arben Taravari, kryetar i Komunës së Gostivarit.

Sipas tij, në sferën e urbanizimi-

GOSTIVARI NJË VIT ME KRYETAR TË RI

PËR TARAVARIN SUKSES, PËR BDI-në DËSHTIM



mit, mundemi të lavdërohem i kemi arritur që, mos themi të çrrënjosim abuzimet, por të paktën t'i reduktojmë në minimum ato. Ndërtimet e egra janë minimizuar, sa falë punës së inspektorëve, aq më shumë nga vetë fakti që askush askënd nuk inkurajon të ndërtojë pa leje apo t'i garantojë se s'ka kush i bën gjë, praktikë kjo shumë prezente në mandatin e shkuar. Do të ndalem shkurt edhe në disa të dhëna në sferën urbanizimit, janë legalizuar 954 objekte të paligjshëm - janë përpunuar 25 PAU Projekte arkitektonike urbanistike prej të cilave 14 të kryera dhe 11 në procedurë, Projekte infrastrukturale 11, Dokumentacione planore lokale urbanistike 3 të kryera dhe 2 në procedurë, Plane detaje urbanistike 16 janë në procedurë prej të cilave disa janë afër fazës përfundimtare dhe 2 janë të miratuar, sepse Ministrive përkatëse nuk u pëlqen të lëshojnë

leje dhe pëlqime, jo vetëm për urbanizëm, por edhe për çerdhe fëmijësh nëpër fshatrat e Gostivarit. Leje ndërtimi gjithsej janë lëshuar 99 leje ndërtimi, prej të cilave 9 për banesa kolektive. Tjetërsimet të tokës ndërtimore 11 të kryera dhe 12 në procedurë", deklaroi ai.

Nga ana tjetër dega e BDI-së në Gostivar menaxhimin e komunës së Gostivarit nga ana e Arben Taravarit e kanë vlerësuar si dështim, demagogji, vajtim, hipokrizi, keqmenaxhim, kriminalitet, nepotizëm dhe gënjeshtër ku kanë përmendur disa nga premtimet e fushatës elektorale të Arben Taravarit të cilat nuk janë realizuar. "Ne si Degë e BDI-së në Gostivar, në hapërimin tonë politik, në pedestal kemi vënë mirëqenien e qytetarit, prandaj ne nuk kemi vënë moton "Të zhurmohet për të ngritur pluhur mediatiko-politik", por si pikësynim të veprimtarisë tonë po-

litike kemi hapërimin pragmatik dhe ruajtjen e interesit dhe të dinjitetit të qytetarit gostivaras. U bënë plot 365 ditë, të nëpërkëmbjes së krenarisë gostivarase, të nëpërkëmbjes së bindjes se qyteti i Gostivarit është qyteti i harmonisë ndërnjerezore, rendit qytetar dhe infrastrukturor, ku pastërtinë e qytetit tonë e lakmonte çdo kalimtarë dhe vizitorë, pra kemi plot 365 ditë dështim, edhe pse ne, nga fillimi ofruam bashkëpunim, ndërsa ti zgjodhe vajtimin. Buxhet manipulativ, joracional, realizim i ulët, asnjë investim kapital, me rritje të vazhdueshme të borxhit publik, dhe më tragjike orientimi i mjeteve të qytetarëve të Gostivarit nëpër kompani të qyteteve të tjera, si: Avokat nga Tetova, Veterinar nga Tetova, mbikqyrës nga Shkupi, projektant nga Shkupi dhe firma "Dafka" nga Shtipi, duke i nënçmuar dhe anashkaluar kompanitë e qytetit tonë. Sot dhe 365 ditë, qytetarët nuk janë të informuar se ku mbarojnë paratë e tyre", tha nënkryetari i degës, së BDI-së në Gostivar, Bashkim Hasani.

Kryetari i Komunës së Gostivarit, Arben Taravari ka premtuar se do të vazhdojë që të punoj me të gjitha kapacitetet edhe në tre vitet e mbetura të mandatit të tij si kryetar i Gostivarit me qëllim që kjo komunë të jetë në top dhjetëshen e komunave më të zhvilluara në vend dhe më transparente. Nga BDI-ja thonë që në vazhdimësi do të bëjnë publike dështimet, gënjeshtër dhe mosmbajtjen e premtimeve.



Franca, kushte të mira për studentët nga Maqedonia

Shkup, 1 nëntor - Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Arbër Ademi, dje mori pjesë në Panairin për studime në Francë, që e ka organizuar Instituti Francez në Shkup dhe departamenti Kampus Frans. Ademi në fjalimin e tij para të pranishmëve theksoi se organizimi i këtyre ngjarjeve si ky Panair është një mundësi dhe ide e shkëlqyer që qytetarët e Maqedonisë të njoftohen me kushtet dhe kriteret për vazhdimin e arsimit të tyre në ndonjë nga institucionet e larta arsimore jashtë vendit, të njoftohen me përparësitë nga edukimi atje dhe të përvetësojnë njohuri internacionale. "Sot, miqtë dhe partnerët tanë nga Franca prezantojnë mundësitë për edukim në institucionet franceze të larta, respektivisht institucionet arsimore të një prej shteteve më të zhvilluara evropiane dhe botërore dhe lider në shumë sfera, duke përfshirë edhe arsimin. Po flasim për një shtet që i kushton kujdes cilësisë së arsimit fillor dhe të mesëm dhe që inicion trendet dhe rrjedhat globale në arsim - shtet ky i cili bën pjesë me përfaqësues të vet në Ranglistën e Shangait me 100 universitetet më të mira në botë, në të cilën gjendet edhe Universiteti i Sorbonës, Universiteti i Parisit dhe të tjerë", theksoi Ademi, duke shtuar se bëhet fjalë për universitete - dyert e të cilave janë të hapura edhe për qytetarët dhe bashkëqytetarët tanë. Dua t'ju rikujtoj, theksoi Ademi, se Ministria e Arsimit ndanë bursa për studentët që do të regjistrohen në ndonjërin nga 100 universitetet më të mira në botë. Ministri Ademi u bëri thirrje të gjithë vizitorëve në këtë Panair që t'i shikojnë të gjitha opsionet që u ofrohen. "Të mendojnë se çfarë i tërheqë dhe të marrin vendim nëse dhe ku do të kishin dashur t'i vazhdojnë studimet në Francë, ku do të përvetësojnë njohuri konkurruese globale, për të cilat, të jem i sinqertë, do të kisha dashur që të barten në vendin tonë dhe të përdoren për përparimin individual dhe të proceseve të përgjithshme shoqërore dhe ekonomike këtu tek ne", tha Ademi.

Hulumtimet e shoqatave pensionale, siç informuan sot, tregojnë se numri i anëtarëve të cilët rregullisht e ndjekin gjendjen e kursimeve pensionale përmes faqeve të internetit të shoqatave pensionale ose të cilat përkohësisht kërkojnë raporte shtesë për kursimet pensionale është i vogël edhe krahas pritjeve, rritet shumë ngadalë

Shkup, 1 nëntor - "Përqendrohu në më të rëndësishmen" është titulluar fushata edukative me të cilën ngritet vetëdija dhe informimi te popullata për punën e shoqatave pensioniste dhe përparësitë nga reforma pensionale e bërë, me fokus në punën e shtyllës së dytë të

FUSHATË PËR VETËDIJE MË TË MADHE PËR KURSIVET PENSIONALE

obligueshme pensionale.

Fushatën e zbatojnë shoqatat pensionale Sava shoqatë pensionale SHA Shkup dhe KB Shoqata e parë pensionale SHA Shkup, në bashkëpunim me Agjencinë për supervizion për sigurim pensional financiar kapital (MAPAS). Ato përmes fushatës bëjnë thirrje për rritje të interesimit të të gjithë qytetarëve për kursimet e tyre personale pensionale, azhurimin e të dhënave të tyre personale dhe shfrytëzimin e mundësisë për kontroll të rregullt të gjendjes në llogarinë e tyre pensionale.

Hulumtimet e shoqatave pensionale, siç informuan sot, tregojnë se numri i anëtarëve të cilët rregullisht e ndjekin gjendjen e kursiv-

meve pensionale përmes faqeve të internetit të shoqatave pensionale ose të cilat përkohësisht kërkojnë raporte shtesë për kursimet pensionale është i vogël edhe krahas pritjeve, rritet shumë ngadalë. Porosia e shoqatave pensionale është të nxitet anëtarësimi në fokusin e kujdesit të përfshirë një segment veçanërisht të rëndësishëm nga jeta dhe planifikimi i të ardhmes, informacionin për gjendjen dhe lëvizjen e kursimit pensional.

Me reformën e bërë në vitin 2006, një pjesë e kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor grumbullohen në njërin nga dy fondet pensionale të obligueshme të shtyllës së dytë dhe investohen

me qëllim të realizimit të ndihmës dhe kapitalizimit të parave të pensionistëve të ardhshëm, me ç'rast do të zvogëlohet ngarkesa mbi Buxhetin e shtetit për mbulimin e pensioneve të shtyllës së parë.

"Si rezultat i investimeve të mira dhe përfitimeve të realizuara të shoqatave pensionale, KB Shoqata e parë pensionale dhe Sava shoqata pensionale në periudhën nga fillimi i punës deri më 30.09.2018, njësia e kontabilitetit të fondeve të obligueshme pensionale (shtylla e dytë) kishte rritje mesatare vjetore prej 5,64 për qind, kumtuan bartësit e fushatës të cilët tregojnë se të dhënat për llogarinë pensionale janë të arritshme në penzija.mk. (Q.A)



Republic of Macedonia
Ministry of Finance

PROJEKT PËR PËRMISMIN E SHËRBIMEVE KOMUNALE - MSIP
(IBRD 8158MK, IBRD 8561MK dhe TF018812)
NUMRI IDENTIFIKUES I PROJEKTIT: P096481 dhe P154464

**SHPALLJE PËR ANGAZHIME PUNUESE NË KOHË TË CAKTUAR
TË PROJEKTIT PËR PËRMIRËSIM TË SHËRBIMEVE KOMUNALE
- MSIP**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë mori hua nga banka Ndërkombëtare për rindërtim dhe zhvillim - banka Botërore dhe një grant i financuar e mjete nga IPA ndihma paraqasëse e Bashkimit Evropian për implementimin e Projektit për përmirësim të shërbimeve komunale.

Projekti ka për qëllim të përmirësojë performancat e ekonomive urbane dhe kualitetin e menaxhimit të nivelit komunal përmes ofrimit të mbështetjes financiare dhe adekuata të më shumë komunave të përzgjedhura në pjesën për planifikim komunal dhe menaxhim dhe ofrim të shërbimeve komunale më kualitative.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë mori hua nga banka Ndërkombëtare për rindërtim dhe zhvillim - me qëllim të implementimit të suksesshëm të Projektit për përmirësim të shërbimeve komunale, Ministria e financave ka nevojë për angazhimin e një individi konsulent vendor për pozicionin në vijim:

- **Konsulent për monitorim dhe vlerësim**

Kompetencat themelore

Shqyrtimin e dokumenteve për vlerësim të projektit të përgatitura nga komunat të cilat marrin pjesë në MSIP, si pjesë e aplikimit për nën-hua ose grante për sukses të MSIP dhe definimin e indikatorëve relevant dhe të matshëm për përcjelljen e çdo nën-projekti të financuar nga mjetet e huazuara nga MSIP, duke përfshirë edhe njësinë matëse të indikatorëve për monitorim, thelbet e tyre dhe vlerat e synuara dhe metodat e grumbullimit. Për nën-projektet të cilat janë në fazë të implementimit me indikatorët e përcaktuar për përcjellje, ndihmë dhe sigurimin e mbështetjes gjatë grumbullimit të vlerave të indikatorëve për përcjellje nga ana e Komunat-pjesëmarrëse.

Për nën-projektet që janë përfunduar, kontrollim të kompletimit të vlerave të indikatorëve për monitorim të grumbulluar nga ana e komunave dhe, gjithmonë kur është e mundur, të ju ndihmohet komunave që të plotësojnë zbrazëtrat në lidhje me grumbullimin dhe përcjelljen e këtyre vlerave.

Analizimi dhe vlerësimi i vlerave të grumbulluara të indikatorëve për përcjellje të nën-projektit dhe vlerësimi i rezultateve nga nën-projektet individuale. Mbledhja e të gjithë indikatorëve për nën-projektet konkrete, komponentët dhe niveli i projektit, vlerësimi dhe prezantimi i rezultateve të arkivuara

Kualifikimet e duhura për konsulent për monitorim dhe vlerësim

- Diplomë universitare nga sfera e ekonomisë ose administrata e biznesit ose financave ose shkallë relevante e ngjashme e arsimit;
- Së paku 5 vite përvojë profesionale relevante, e cila përfshin 1 vit përvojë në fusha të ngjashme (si ato të investimeve, analizë financiare dhe ekonomike të investimeve etj);
- Përvojë në zhvillimin e Dokumenteve për vlerësim të projekteve ose Studime për fizibilitet për projektet e investimeve do të konsiderohet si përparësi;
- Ekspertizë e suksesshme e dëshmuar në 3 vite e fundit të pregaditjeve, ose vlerësimin e projekteve, përvojë në përcjellje dhe vlerësim të rezultateve dhe efektivitetin e programit të investimeve/projekteve do të konsiderohet si përparësi;
- Përvojë e suksesshme e dëshmuar në bashkëpunim me institucionet qeveritare, duke përfshirë edhe qeverisjen lokale (komunat) dhe institucionet financiare ndërkombëtare;
- Aftësi kompjuterike dhe ekspertizë në gjuhën maqedone dhe njohuri të gjuhës angleze për punë.

Personat për pozicionin e deklaruar për konsulent do të përzgjidhen në pajtim me botimin "**Drejtme: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga ana e huamarrësve të bankës Botërore**" publikuar nga ana e bankës Botërore në janar të vitit 2011, e rishikuar në korrik të vitit 2014.

Konsulentët e interesuar ftohen që të parashtojnë biografit e tyre punuese në gjuhën angleze, ku mbi të gjitha duhet të përmbajnë një rishikim e cila e konfirmon kualifikimin e tyre për plotësimin e kualifikimeve të theksuara më lartë (në aplikim patjetër duhet të theksohet pozicioni për të cilin aplikohet)

Interesimi i shfaqur, me biografinë punuese, letër motivimi dhe të gjitha dokumentet tjera relevante përkatëse, duhet të parashtohen në mënyrë elektronike në formatin pdf ose word dokument madhësia e të cilit nuk e kalon 10MB, në adresën e theksuar në vijim, jo më vonë se **16 nëntor 2018, deri në orën 16:30**

Ministria e financave
Dame Grujev, 12
1000 Shkup
Republika e Maqedonisë
e-mail: aleksandar.najdovski@finance.gov.mk



Republic of Macedonia
Ministry of Relations

THIRRJE PËR SHFAQJE TË INTERESIT

REPUBLIKA E MAQEDONISË
PROJEKT PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE KOMUNALE - (MSIP)
Marrëveshje për grant për IPA NR. TF018812

NDIHMË TEKNIKE: MBIKËQYRJE TË PROJEKTIMIT DHE NDËRTIMIT TË SISTEMEVE DIELLORE FOTOVOLTAIKE NË KOMUNAT RURALE

Qeveria e Republikës së Maqedonisë - Ministria e financave ka fituar një grant nga Bashkimi Evropian në vlerë prej 15.5 milion Euro për implementimin e IPA programit investues rural të cilin e zbaton Ministria e financave, ndërsa është e administruar nga ana e bankës Botërore. Në pajtim me kushtet e marrëveshjes për grant Ministria e financave ka për qëllim që një pjesë të mjeteve t'i drejtojë për pagesën e marrëveshjes për ndihmën teknike për mbikëqyrje të projektimit dhe ndërtimit të sistemeve fotovoltaike në komunat rurale.

Shërbimet e konsulentit ("shërbime") përfshijnë: ndihmë teknike për mbikëqyrje të projektimit dhe ndërtimit të sistemeve fotovoltaike në komunat rurale në pajtim me ligjin e Maqedonisë për ndërtim, kushtet e lokacioneve dhe miratimi për ndërtimit. Informata më të hollësishme në raport me kualifikimet e duhura mund të gjinden në linkun në vijim: <http://www.finance.gov.mk/node/1056>.

Ministria e financave bën thirrje të firmat konsulente të kualifikuara ("konsulentë") të shfaqin interes për ofrimin e shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të parashtojnë informacione me të cilat do të dëshmojnë që i posedojnë kualifikimet e duhura dhe përvojën relevante për realizimin e shërbimeve.

Të njëjtit duhet të plotësojnë kriteret në vijim:

- Licencë për mbikëqyrje të kategorisë II të objekteve (Licenca B), e lëshuar nga Ministria e transportit dhe lidhjeve e RM;
- Kompania konsulente duhet ta dëshmojë aftësinë e saj dhe përshtatshmërinë për mbikëqyrje të ndërtimit me listë të detajuar me së paku dy (2) mbikëqyrje individuale të realizuara të punimeve të ndërtimit për ndërtimin e sistemeve diellore fotovoltaike në 10 vitet e fundit;
- Së paku 40 të punësuar me orar të plotë;
- Konsulenti duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve në vijim:

ISO 9001: 2008 Sistem për menaxhim me cilësi.

ISO 14001: 2004 Sistem për menaxhim me mjedisin jetësor.

Konsulentët e interesuar veçanërisht duhet ta marrin parasysh paragrafin 1.9 nga Udhëzimet e bankës Botërore:

Përzgjedhja dhe angazhimi i konsulentëve brenda IBRD dhe IDA kredive dhe grantëve për huamarrësit nga banka Botërore nga janari i vitit 2011 ("Udhëzime për konsulentët") duke marrë parasysh politikën e bankës Botërore për konflikt të interesave. Konsulentët mund të formojnë një konsorcium ose investim të përbashkët me firma tjera me qëllim të përmirësimit të kualifikimeve të tyre. Konsulenti do të përzgjidhet në pajtim me mënyrën për zgjedhje të konsulentëve e theksuar në Udhëzimet për konsulentët.

Informata shtesë mund të merren në adresën e theksuar më poshtë gjatë orarit të punës nga ora 08:30-16:30, nga e hëna deri të premten. Shfaqja e interesit mund të parashtrohen në formë të shkruar në adresën e theksuar më poshtë (personalisht, përmes postës ose përmes e-mail) më së voni deri më **16 nëntor 2018**.

Ministria e financave

Projekt për përmirësimin e shërbimeve komunale

Ndihmë teknike: mbikëqyrje të projektimit dhe ndërtimit të sistemeve fotovoltaike në komunat rurale

Dame Grujev, 12, Shkup, 1000
Deri te: Aleksandar Najdovski
Tel: +389 2 3255735

Aleksandar.Najdovski@finance.gov.mk

Konkursi publik për zgjedhjen e Drejtorit të Ndërmarrjes Publike "Higjiena" –Tearcë

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 9 nga Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e R.M.", nr. 5/02), dhe në lidhje me nenin 23 paragrafi 3 nga Ligji për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e R.M.", nr. 38/96, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16, 64/18), Kryetari i komunës së Tearcës, shpall:

Konkurs publik për zgjedhjen e Drejtorit të NP "Higjiena" – Tearcë.

1. Shpallet konkursi publik për zgjedhjen e Drejtorit të Ndërmarrjes publike "Higjiena" Tearcë - komuna e Tearcës.

2. Kandidatët të cilët do të paraqiten në konkursin publik për zgjedhje të drejtorit të Ndërmarrjes publike "Higjiena"-Tearcë duhet t'i plotësojnë kriteret në vijim:

-të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë

-në momentin e emërimit me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës nuk i është shqiptuar dënim me gjobë ose kundërvajtje për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

3. Përveç kushteve të përgjithshme për punësim ata duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme të posaçme:

-të ketë të paktën 180 kredi sipas ECTS ose të përfunduar VII/1 nivelin e arsimit.

-të ketë të paktën 5 vjet përvojë pune dhe aftësi menaxhuese.

-të posedojnë njërin nga certifikatat ose vërtetimi të njohur ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze, jo më e vjetër se pesë vjet, edhe atë: TOEFL iBT- më së paku 74 pikë, IELTS – më së paku 6 pikë, ILEC Cambridge English:Legal – më së paku niveli B2, FCE Cambridge English:First-me provim të dhënë ose BULATS – më së paku 60 pikë.

4. Përveç aplikimit në konkursin për përzgjedhjen e drejtorit të Ndërmarrjes Publike, kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

-Certifikata e Shtetësisë (origjinal ose kopje e noterizuar)

-Dëshmi për arsimin e kryer universitar i cili është përcaktuar me konkurs (origjinal ose kopje e vërtetuar nga noteri publik)

-Dëshmia e përvojës së punës së kandidatit që aplikon për shpalljen e përzgjedhjes së drejtorit të Ndërmarrjes publike.

-Një vërtetim që një vendim gjyqësor i formës së prerë nuk i është shqiptuar një dënim ose kundërvajtje ndalimi për kryerjen e një profesioni, veprimtarie ose detyre (origjinale ose kopje të vërtetuar nga noteri, jo më të vjetër se gjashtë muaj)

5. Afati i fundit për aplikim për konkursin publik është 10 (dhjetë) ditë nga dita e shpalljes në shtypin ditor.

6. Kandidatët për konkursin publik duhet të dorëzojnë aplikacionin me postë në adresën e Komuna e Tearcës rruga "101" p.n. ose personalisht në arkivin e komunës në të njëjtën adresë, në një zarf të mbyllur me njoftim për konkurs publik për zgjedhjen e drejtorit.

7. Dokumentacioni i paplotë dhe dokumentacioni i paraqitur pas kalimit të afatit të aplikimit nuk do të merret parasysh.

Komuna e Tearcës
Kryetar
Isen Asani



KOMUNA E BUTELIT

Nr. 09-1043/8 nga 31.10.2018

Shkup

Në bazë të nenit 35, ndërsa në lidhje me nenin 51 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016 163/2016 dhe 64/18), Kryetari i Komunës së Butelit e shpall këtë:

NJOFTIM

Njoftohen banorët dhe personat juridik që Kryetari i Komunës së Butelit ka sjell Vendim për organizimin e:

PREZANTIM PUBLIK DHE ANKETË PUBLIKE

për projektin Arkitektonik-urbanistik për formimin e komplot ndërtimit nga pjesë prej PK 245/1, me qëllim G4 - depo për shitje të materialit ndërtimor, në Bllokun 4 nga PUJVB për zonën industriale Vizbeg / përpunim të Bllokut 12/, KK Vizbeg, Komuna Butel

Hapësira që përfshin projekti Arkitektonik-urbanistik për formimin e komplot ndërtimit nga pjesë prej PK 245/1, me qëllim G4 - depo për shitje të materialit ndërtimor në Bllokun 4 nga PUJVB për zonën industriale Vizbeg / përpunim të Bllokut 12/, KK Vizbeg, komuna Butel, është me sipërfaqe prej 6 625 m².

Kufiri i hapësirës që përfshin projekti është i dhënë në koordinatat x dhe y në vijim:

- 1 Y=532864.0016 X=655043.6735
- 2 Y=532836.6200 X=655031.0100
- 3 Y=532835.5400 X=655030.5100
- 4 Y=532817.6338 X=655022.2366
- 5 Y=532834.5918 X=654973.0778
- 6 Y=532837.4417 X=654964.7114
- 7 Y=532839.0631 X=654959.9513
- 8 Y=532892.4622 X=654984.7714
- 9 Y=532929.8300 X=655002.1400
- 10 Y=532935.0900 X=655004.6200
- 11 Y=532932.0200 X=655010.7200
- 12 Y=532919.3900 X=655035.7700
- 13 Y=532907.5600 X=655059.6000
- 14 Y=532906.0000 X=655061.9900
- 15 Y=532901.2500 X=655060.0200
- 16 Y=532899.8500 X=655059.4400
- 17 Y=532882.8600 X=655052.3900
- 18 Y=532867.6200 X=655045.3500
- 19 Y=532866.7400 X=655044.9400

Plani Arkitektonik-urbanistik i përpunuar me bashkëngjitet grafike do të ekspozohet në një vend publik të hapësirave të Komunës së Butelit në sallën për takime (salla e vogël).

Anketa publike do të mbahet prej 07.11.2018 deri më 13.11.2018 (pesë ditë pune), çdo ditë pune nga ora 08.30 deri 15.30 në hapësirat e Komunës së Butelit në sallën për takime (salla e vogël).

Në afatin e përcaktuar personat fizik dhe juridik të interesuar mund të parashtojnë vërejtje në fletat anketuese në formë elektronike përmes sistemit informativ e-urbanizim ose në formë shkrimi.

Fletat anketuese për pjesëmarrje në anketën Publike mund të tërhiqen në Komunën e Butelit (në sportel).

Njoftimi për organizimin e anketës publike do të publikohet në media të informimit, në sistemin informativ e-urbanizim dhe në ueb faqen e Komunës së Butelit.

Anketa publike për projektin Arkitektonik-urbanistik për formimin e komplot ndërtimit nga pjesë prej PK 245/1, me qëllim G4 - depo për shitje të materialit ndërtimor, në Bllokun 4 nga PUJVB për zonën industriale Vizbeg / përpunim të Bllokut 12/, KK Vizbeg, Komuna Butel, do të mbahet në hapësirat e Komunës së Butelit, në sallën për takime (salla e vogël), më datë 08.11.2018, me fillim prej orës 11:00.

KRYETAR
Velimir Smilevski

TRAJTIMI I QENVE ENDACAK

MIRATOHET PROGRAM I POSAÇËM

Sipas programit, njëzet qen do të kapen çdo muaj, kurse në vit diku rreth 240. Në periudhën post operative, kafshët vendosen në kafazet e destinuara, përkatësisht në bokset, kryhet ushqimi i rregullt, me mbikëqyrje permanente nga ana e profesionistëve përkatës



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 1 nëntor - Qentë endacak nga qyteti do të trajtohen në mënyrën e duhur me procedura të ndryshme dhe pastaj do të dërgohen në veterinar, kurse stacioni do të jetë në rrugën "Gostivari", në kuadër të njësisë Higjiena komunale. Kjo është vendosur në seancën e fundit të këshillit të komunës së Tetovës. Nga Sektori për veprimtari komunale, mbrojtje të ambientit dhe natyrës thonë se do të përcaktohet edhe operator që do të merret me këtë problematikë dhe pritet shumë shpejt të fillojë.

"Stacionari është objekt me ndërtim të fortë, me lokacion në kuadër të NPK-së, i pajisur me hapësira përkatëse për trajtimin mjekësor si dhe kafaze – bokse, për vendosjen e kafshëve. Kafshët e kapura transportohen deri te stacionari, ku bëhet kontrolli klinik në të cilin klasifikohen kafshët që i plotësojnë kriteret e eutanazisë.

Të gjitha kafshët e shëndosha nga ana klinike transportohen në pjesën spitalore. Identifikimi i terrenit për çdo kafshë të kapur evidentohej menjëherë dhe regjistrohen edhe të dhënat tjera për kafshët, siç janë raca, gjinia, mosha, shenja të posaçme, vendi i kapjes", thonë nga Sektori për veprimtari komunale, mbrojtje të ambientit dhe natyrës. Sipas programit, njëzet qen do të kapen çdo muaj, kurse në vit diku rreth 240.

"Në vitin 2018 parashikohet kapja dhe trajtim i rreth 20 kafshëve në muaj, përkatësisht rreth 240 në vit. Trajtimi veterinar i kafshëve do të realizohet nëpërmjet mjekut të mjekësisë veterinare. Aktivitetet do të kryhen në tre ndërrime. Në ndërrimin e parë dhe të dytë ditor do të kryhen obligimet e zakonshme për kontrollin e brezave të qytetit, në përputhje me Programin, por edhe do të interve-

nohet me kërkesë të qytetarëve. Ndërrimi i tretë i natës në varësi të kushteve klimaterike do të zhvillohet në mbrëmje dhe herët në mëngjes, gjatë kësaj parashikohet kontrolli i brezave tashmë të përpunuara dhe intervenime të seriozitetit", tha Juliana Peneva, bashkëpunëtoreshë e lartë në Sektorin për veprimtari komunale, mbrojtje të ambientit dhe natyrës. Sipas saj, këshilltarët në bazë të propozimit të Komunës së Tetovës për këtë qëllim kanë ndarë 500 mijë denarë nga buxheti i kësaj komune. Për vitin e ardhshëm parashihet që të rriten mjetet buxhetore për këtë qëllim."

Në periudhën postoperative, kafshët vendosen në kafazet e destinuara, përkatësisht në bokset, kryhet ushqimi i rregullt, me mbikëqyrje permanente nga ana e profesionistëve përkatës. Bokset e qendrës stacionare pastrohen rre-

gullisht, dezinfektohen dhe kryhet dezinfektimi dhe sipas nevojës edhe deratizimi përkatës i tërë hapësirës së stacionarit. Para largimit nga stacionari, bëhet vaksinimi i kafshëve kundër tërbimit dhe dehelmentacioni. Kafshët e caktuara kthehen përafësisht në lokalitetin e njëjtë ku janë kapur më parë, me shenjë të verdhë në vesh", shprehet Peneva. Kjo është parashikuar nga drafti i programit i miratuar njëzëri në seancën e fundit të këshillit të komunës së Tetovës, me realizimin e të cilit një nga problemet më të mëdha të qytetit duhet të zgjidhet. Punëtorët e angazhuar për kapjen e qenve endacak dhe maceve janë të pajisur me uniformë dhe pajisje përkatëse dhe mjete për vetëmbrojtje, si dhe pajisjet: automjetet adekuat me rimorkio, lak dhe rrjetë për kapje, pushkë safari për vënien e përkohshme në gjumë me mjete për paralizë të përkohshme – fjetje, shporta - kafaze për transportim, qafore dhe tërheqëse, mjete përkatëse dhe pajisje për evidencën dhe identifikimin e kafshëve të kapura. Transporti nga vendi i kapjes deri në stacionar kryhet me automjetet të specializuara të pajisur me kafaz përkatës për vendosjen e kafshëve. Uniforma dhe automjeti janë të dallueshme me mbishkrimet, thonë në këtë sektor. Përndryshe, ditë më parë edhe komuna e Gostivarit e filloi këtë aktivitet ndërsa komunat tjera rurale ende nuk kanë marrë ndonjë hap konkret për trajtimin e problemit me qentë endacak. Dhe përderisa programa ka kaluar në këshill edhe gjatë këtyre ditëve vërehen qen endacak në rrugët kryesore të Tetovës.

Etemi do të ndërtojë park të ri në Aerodrom

Shkup, 1 nëntor - Pronari i ndërtesës që duhet të ndërtohet afër "Majçin Dom" në Komunën e Aerodromit, Fatmir Etemi përmes një njoftimi paralajmëroi se do të investojë mjete për ndërtimin e një parku të ri në komunë. "Ky është kontributi ynë për komunën dhe qytetarët. Kompania jonë ka përgjegjësi shoqërore dhe duam të sigurojmë kushte më të mira për jetesë në Aerodrom. Qëndroj në dispozicion edhe për projekte tjera ekologjike në komunë dhe në proces jam i gatshëm t'i përfshijë tërësisht qytetarët", thotë pronari Fatmir Etemi. Ai paralajmëroi vazhdimin e punëve ndërtimore në vendin para "Majçin dom" pasi dje Gjykata Kushtetuese nuk inicioi procedurë për ankesat e parashtruara për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së PUD P10, ndërsa më pas edhe nga komuna e Aerodromit kumtuam se janë shfrytëzuar të gjitha mekanizmat që të ndalohet ndërtimi i objektit. Kundër ndërtimit të ndërtesës afër "Majçin dom" protestuan banorët lokal. Pas reagimit komuna e Aerodromit vendosi ndalesë të përkohshme 15-të ditore për kryerjen e punëve ndërtimore. Nga Komuna thonë se PUD P10 në mënyrë të fshehtë pa debat dhe drejtpërdrejt është sjell nga udhëheqësia e komunës e kryesuar nga VMRO-DPMNE.

NIVEL I ULËT I ZHVILLIMIT TË SIGURIMIT BUJQËSOR

BUJQIT E PASIGURT

Të dhënat që dje në pres konferencë në Qeveri i prezantoi Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, tregojnë se tetëdhjetë e gjashtë për qind nga premia e përgjithshme i dedikohet sigurimit të mbjellave dhe frutave, ndërsa 14 për qind sigurimit të bagëtive



Koha Qefser ABDYLI

Shkup, 1 nëntor - Nga numri i përgjithshëm i fermerëve të regjistruar vetëm 4 për qind janë të siguruar me polisa për sigurim bujqësor. Përqindja më e madhe është e personave juridik të cilët sigurojnë sipërfaqet bujqësore, se sa përqindja e personave fizik, ose 28 për qind u përket personave fizik, ndërsa 72 personave juridik. Të dhënat që dje në pres konferencë në Qeveri i prezantoi Agjen-

cia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, tregojnë se tetëdhjetë e gjashtë për qind nga premia e përgjithshme i dedikohet sigurimit të mbjellave dhe frutave, ndërsa 14 për qind sigurimit të bagëtive.

"Të ardhurat e realizuara nga shitja e polisave për sigurim bujqësor në tre muajt e tretë 2018 arrijnë shumën më të lartë të premive, derisa dëmet e paguara arrijnë 125 milionë denarë. Kjo do të thotë se kompanitë e sigurimit i kthejnë paratë dhe e ndihmojnë

bujqësinë me pagesën e dëmeve. Megjithatë fotografia e përgjithshme tregon se ekziston zhvillim i ulët i sigurimit bujqësor", ka thënë drejtori i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Klime Popovski. Sipas zëvendëskryeministrit për çështje ekonomike, Koço Angjushev në Maqedoni ka problem edhe në anën e biznesmenëve dhe të kompanive të sigurimit, në një anë ajo që duhet bërë është të ngritet ndërgjegjësimi i biznesmenëve për përfitimet nga sigurimi, ndër-


sa në anën tjetër të punohet në ngritjen e profesionalizmit të kompanive të sigurimit.

"Vetëm puna profesionale e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve, rregulla mirë të vendosura të lojës dhe kriteret e qarta, kontrata nga kompanitë e sigurimit janë garanci për fermerët se do ta fitojnë mbështetjen që e kanë paguar me pagesën e premisë së sigurimit", ka thënë Angjushev. Ndërkohë, ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujë-

rave, Lupço Nikollovski pajtohet se ende është i vogël numri i fermerëve që i sigurojnë të mbjellat e tyre dhe se duhet të punohet në atë drejtim dhe të ndërtohet sistemi efikas i sigurimit në bujqësi që gjithnjë e më shumë po i nënshtrohet ndryshimeve klimatike. "Në vitin 2017 përmes Agjencisë për përkrahje financiare janë paguar 4.5 milionë euro gjithsej dëme lidhur me gjitha fatkeqësitë të cilat ndodhën", ka thënë Nikollovski.

Popull i zgjedhur?!

Nga
Gideon LEVY



Do të doja të takoja përfaqësuesit e asaj shumice absolute, përcaktuese, arrogante dhe patronizuese që rezultojnë nga sondazhi i fundit i Haaretz dhe t'i pyes: Me gjithë mend e keni? Si ju shkon ndërmend një gjë e tillë? Për kë e keni fjalën? A jeni ju, shumica absolute, kaq të sigurtë se ne (hebrejtë) jemi - të zgjedhur, më të mirë, se ne jemi kampionët, koka dhe shpatullat mbi trupin e të gjithëve?

Si dolët në këtë përfundim? Do të doja të të pyesja e dashur shumicë: mbi ç'bazë jeni të bindur se ne jemi populli i zgjedhur, se ne dimë cdo gjë më mirë sesa kombet e tjera; se ne meritojmë më shumë sesa të tjerët; se ajo që vlen për ata nuk vlen për ne, sepse ne jemi superiorë?

Ja si u përgjigj shumica e izraelitëve në sondazhin e dialogut publikuar javën e kaluar nga Haaretz: Ne jemi një popull i zgjedhur. Një shumicë, 56% , janë të sigurtë për këtë. Të dhënat rriten në 79%, një shumicë absolute, mes atyre që vetë-identifikohen si të kraut të djathtë. Në një vend ku 76% e njerëzve besojnë në Zot, apo në fuqi të tjera sipërore, ndoshta një gjë e tillë është e kuptueshme. Por ndërsa besimi në Zot është një çështje private, besimi i të qenit një popull i zgjedhur zbulon konturet e një politike që shpjegon shumëçka rrethe veprimeve të Izraelit.

Le të kalojmë nga teologjia te patologjia. Hebrejtë e Izraelit që mendojnë se i përkasin një populli të zgjedhur dhe përzgjedhur kanë një detyrim ndaj vetes dhe të tjerëve. Është e lehtë të deklarosh se Zoti ekziston ose jo. Askush nuk pret prova, por kur shumica e një kombi është e bindur se është superiore ndaj të gjitha kombeve të tjera, disa prova janë të domosdoshme. Në rastin e Izraelit, është e thjeshtë të provosh se kemi të bëjmë me një shkëputje nga realiteti, një deluzion i rrezikshëm. Në çdo ngjarje, një popull që është i bindur se është i zgjedhur përbën rrezik për veten dhe ata që e rrethojnë.

Hebrejtë janë në të vërtetë speciale, me një histori të përgjakur dhe të lavdishme. Hebrejtë e Izraelit kanë po ashtu me çfarë të krenohen. Por kur ata thonë se janë popull i zgjedhur, kjo zbulon psikozën e tyre. Është e dyshimtë nëse ndonjë komb e mendon këtë gjë për veten. Edhe hebrejtë e Izraelit nuk kanë arsye ta mendojnë veten të zgjedhur. Në ç'mënyrë janë ata të zgjedhur? Në cilat gjëra janë



ata më të mirë? Dhe çfarë duhet të mendojë një suedez, francez, amerikan, britanik apo arab për këtë arrogancë të padurueshme?

Nuk ka nevojë të elaborohet shumë mbi pikëpyetjet morale të Izraelit si një pushtues. Çdo izraelit me një fije ndërgjegjeje e di se një komb pushtues nuk mund të jetë një popull i zgjedhur. Nuk vjen gjë e keqe as edhe nga pak përlutësi kur vjen puna te disa karakteristika të njerëzve në Izrael, përpara se të vetëkurorëzohemi një fener mes kombeve. Unë reko-

mandoj p.sh të lexohet analiza gjithëpërfshirëse dhe tmerruese e Dan Ben-David, publikuar në Haaretz mbi sistemin arsimor në vendin tonë, e cila nuk u shoqërua me reagimin e duhur. Gjysma e fëmijëve në Izrael marrin një arsimim si ai në Botën e Tretë.

Na duhet edhe pak modesti për ne si qytetarë të një shteti që renditet në vendin e 87-ë në Indeksin e Lirisë së Shtypit për vitin 2018, poshtë Togos dhe Bregut të Fildishtë. Edhe vendi i 32-ë në Indeksin e Perceptimit të

Përkëdhelja me vetëglorifikim është kthyer në tipar të spikatur të karakterit kombëtar izraelit. E djathta e shpërndan këtë gënjeshtëri për qëllimet e veta. Populizmi lajkatues nuk po lulëzon vetëm në Izrael, por vetëm këtu pabarazia mes ëndrrës dhe realitetit është kaq e madhe. Një popull i zgjedhur? Sikur të ishte më në fund si të gjithë kombet e tjerë!



Korrupsionit, publikuar nga Transparency International në vitin 2017, nuk është diçka për t'u festuar. Kujdesi shëndetësor është edhe kjo një fushë ku vetëvlerësimi i Izraelit duhet të përkulet: vendi renditet i 28-i në shpenzimet për kujdesin shëndetësor, nga 36 që janë vendet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe i 30-i për numrin e shtretërve në spitale.

Sjellja e turistëve izraelitë nuk u përshtatet përherë kërkesave të një populli të zgjedhur. Ndoshta Izraeli renditet në krye në një indeks për blerjen e nëndetësive gjermane dhe ndoshta ky është çelësi për të kuptuar ndjesinë e epërsisë.

Përkëdhelja me vetëglorifikim është kthyer në tipar të spikatur të karakterit kombëtar izraelit. Thjesht lexoni të përditshmen "Izrael Hayom" apo dëgjoni kryeministrin. Sa të dashur që jemi nga mëngjesi në darkë!

E djathta e shpërndan këtë gënjeshtëri për qëllimet e veta. Populizmi lajkatues nuk po lulëzon vetëm në Izrael, por vetëm këtu pabarazia mes ëndrrës dhe realitetit është kaq e madhe. Një popull i zgjedhur? Sikur të ishte më në fund si të gjithë kombet e tjerë!

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 1 nëntor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Pafuqia e plotfuqishmit



Nga
Havier SOLANA

Debat i përgjithshëm vjetor i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara është një nga ngjarjet më të rëndësishme në kalendarin diplomatik ndërkombëtar. Si zakonisht, takimi i këtij viti, gjatë javës së fundit të muajit shtator, solli në Nju Jork një listë të gjatë udhëheqësish botërorë, edhe pse ndoshta termi "udhëheqësi botëror" nuk duhet të përdoret me aq lehtësi.

Presidenti i fuqisë udhëheqëse globale, e ka bërë të qartë se ai nuk ka interes të përfshihet në zgjidhjen e ndonjërit prej problemeve të përbashkëta të botës. Mjerisht, ai nuk është i vetëm në këtë pretendim. Për ata prej nesh, që e vendosin besimin tonë tek bashkëpunimi ndërkombëtar, si një plotësues i domosdoshëm për globalizimin ekonomik, debati i Asamblesë së Përgjithshme zbuloi një panoramë të zymtë. Interesat afatshkurtra të udhëheqësve të caktuar, që paraqiten shpesh si "interesa kombëtare", janë një ndër faktorët që kanë dëmtuar më shumë marrëdhëniet ndërkombëtare sesa në çdo kohë, që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Por rritja e populizmit nacionalist, është më pak shkak dhe jo rezultati i përçarjeve, që janë formësuar prej njëfarë kohe.

Ashtu si me çdo proces ekonomik, globalizimi ka një dimension shpërndarës, që do të thotë se është i detyruar të krijojë frustrime për disa grupe njerëzish. Qendra e spektrit politik perëndimor, ka tentuar të nënvlerësojë ndikimin e rritjes së pabarazisë brenda vendeve, duke u përqendruar në përfitimet e hapjes dhe integritetit të tregut, siç është reduktimi i paprecedentë i varfërisë globale. Gjithësesi, kuptohet që jo të gjithë ngushëllohen nga rezultate të tilla. Nuk janë vetëm mallrat, shërbimet dhe kapitali, ato që qarkullojnë nëpërmjet ekonomisë globale. Edhe idetë gjithashtu.

Pra, globalizimi, ashtu si demokracia, është i ndjeshëm ndaj vetvetes, pasi vendos në dispozicion të kundërshtarëve një sërë mjeteve, që ata mund të përdorin për ta sabotuar atë.

Të vetëdijshëm për këtë fakt, "nacionalistët internacionalistë" të drejtuar nga presidenti amerikan SHBA, Donald Trump dhe udhëtarët e tij ideologjikë, kanë mobilizuar ankthin dhe alienizimin, për të nisur një kryqëzatë (disi paradoksale), për të globalizuar diskursin e tyre të veçantë kundër globalizimit. Duke ju drejtuar

Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, Trump deklaroi haptazi se "ne e hedhim poshtë ideologjinë e globalizmit, dhe përqafojmë doktrinën e patriotizmit". Ai mbushi me lavdata shtetet e tjera të tilla si Polonia, që ndjekin shembullin e tij. Nëse brazilianët zgjedhin kandidatin presidencial të ekstremit të djathtë Xhair Bolsonaro, ata do t'i bashkohen valës së populizmit nacionalist, që kërcënon të zbëjë institucionet shumëpalëshe të botës.

Megjithatë, globalizmi dhe patriotizmi, nuk janë koncepte të papajtueshme mes tyre. Apeli i Trumpit ndaj patriotizmit, nuk ka asnjë qëllim tjetër, përveçse të zburorë tendencat e tij nacionaliste dhe nativiste. Kurthe retorike të këtij lloji, mund të na kapin në befasi, sidomos kur personi që i ngrato, është një lider i njohur për prezantimin e ideve të tij të papërpunuara. Por është e qartë, që edhe administrata e Trump shqetësohet për formën e paraqitjeve. Ka shumë shembuj të tjerë. Në OKB, Trump kërkoi që politika e tij të jashtme të jetë koherente, duke e quajtur këtë "realizëm parimor".

Në marrëdhëniet ndërkombëtare, realizmi është një teori që i konsideron shtetet si aktorë dhe njësi qendrore të analizave, duke lidhur institucionet dhe ligjin ndërkombëtar, me statusin e ndërvarësisë. Parimet si të drejtat e njeriut, lihen zakonisht mënjanë, edhe pse vendet mund t'i zbatojnë ato në mënyrë selektive, për të çuar përpara interesat e tyre. Pikërisht këtë bënte Trump, kur kritikonte repre-

sionin e regjimit iranian, duke mos denoncuar praktika të ngjashme në vende të tjera. Por asnjë realist i vetë-respektuar, nuk do të ekzagjeronte kërcënimin e paraqitur nga Irani, apo të lejonte që një takim plot komplimente mes Trump-Kim Jong-un, të ndryshojë vizionin e tyre në lidhje me Korenë e Veriut.

"Amerika do të zgjedhë gjithmonë pavarësinë dhe bashkëpunimin mbi qeverisjen, kontrollin dhe dominimin global", tha Trump në OKB. Në teori, bashkëpunimi nuk është i papajtueshëm me paradigmen realiste. Për shembull, realistët mund ta përfytyrojnë SHBA-në që përpiqet të kompensojë rritjen gjeopolitike të Kinës, me forcimin e aleancave të saj në rajonin e Azi-Paqësorit, veçanërisht me Japoninë dhe Korenë e Jugut. Por administrata Trump, ka vënë në pikëpyetje ombrellën e sigurisë që ajo parashikon për këto vende, madje duke mos i përjashtuar këto të fundit nga masat e saj tregtare proteksioniste (edhe pse përditësimi i fundit i marrëveshjes dypalëshe me Korenë e Jugut, duket se ka qetësuar disi ujërat).

Kjo sjellje shqetësuese, është shtrirë edhe tek aleatët e tjerë tradicionalë të SHBA, si Bashkimi Europian, duke zbuluar se Trump është jashtëzakonisht hezitues për të bashkëpunuar. Edhe kur e bënë këtë, ai rrallë preferon aleancat që i përshtaten më mirë interesave strategjike të vendit të tij. Lidhur me Kinën, diplomacia amerikane përdor shprehimisht termin "konkurrencë", pavarësisht nga



Abdikimi i Amerikës nga udhëheqja globale nën administratën Trump, ngre një pikëpyetje të qartë: Ç'të mirë ka fuqia mbizotëruese në botë, nëse përballë sfidave më të mëdha globale, qeveria e saj zgjedh ta dënojë vetveten me pafuqi?

marrëdhëniet miqësore që Trump pretendon se ka me homologun kinez Xi Jinping. Lufta e vazhdueshme tregtare (dhe teknologjike) midis dy vendeve, së bashku me periudhat e fërkimit në Detin e Kinës Jugore, duket se paraqesin një spirale të pakontrollueshme të përballjes mes dy vendeve. Megjithatë, ky skenar (që mund të parashikohet nga shkolla realiste) mund të shmanget, veçanërisht nëse ruajmë strukturat ekzistuese të qeverisjes shumëpalëshe, të cilat mund të na ndihmojnë të menaxhojmë ndryshime në balancën

e pushtetit.

Është e qartë që Kina nuk i përmbahet gjithmonë normave ndërkombëtare, por përgjigja e duhur është të mbështeten këto norma, dhe jo të sulmohen ato. Fatkeqësisht, SHBA-ja ka zgjedhur kursin e fundit në shumë fusha, siç janë marrëdhëniet tregtare. Në fjalimin në Asamblesë së Përgjithshme të OKB, ministri i Jashtëm kinz, Uang Ji, nuk e vuri theksin tek realpolitika që promovon shpesh vendi i tij; përkundrazi, ai përmendi jo më pak se 5 herë konceptin "win-win".

Nëse Trump - së bashku me pjesën tjetër të nacionalistëve internacionalistë - vazhdon të refuzojë këtë nocion përfitimesh reciproke, ai ka gjasa të ngadalësojë jo vetëm rritjen e Kinës, por edhe atë të SHBA-së. Edhe më alarmuese, mospërfillja ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar, do të thotë ta lësh botën të dorëzuar përballë çështjeve ekzistenciale si ndryshimi i klimës, një qëndrim neglizhent, që administrata e Trump e ka adoptuar me kënaqësi. Abdikimi i Amerikës nga udhëheqja globale nën administratën Trump, ngre një pikëpyetje të qartë: Ç'të mirë ka fuqia mbizotëruese në botë, nëse përballë sfidave më të mëdha globale, qeveria e saj zgjedh ta dënojë vetveten me pafuqi?

(Shënim: Javier Solana, ka qenë Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, dhe Ministri i Jashtëm i Spanjës)





FESTIVALI I FUNDVITIT NË RTSH, "LUFTË" E ASHPËR MES ARTISTËVE TË NJOHUR


Jonida Maliqi, Eliza Hoxha, Bojken Lako, Elton Deda, Vikena Kamenica e Soni Malaj konkurojnë për çmimin e parë

Koha Blerand REXHEPI

Festivali i Këngës në Radio Televizionin Shqiptarë duket se premtion edhe këtë vit surpriza. Pas edicionit të vitit të kaluar, ku në festival pati më shumë se dy emra pretendentë, duket se edhe këtë vit konkurrenca do të jetë e fortë. Emra të tillë si Eliza Hoxha, Eranda Libohova, Jonida Maliqi, Soni Malaj, Vikena Kamenica, rikthehen në skenën e festivalit të fundvitit pas shumë vitesh.

Ndërkohë të tjerë emra të njohur si Bojken Lako, Elton Deda, Orgesa Zaimi, etj, vazhdojnë pjesëmarrjet në këtë kompeticion, për të provuar emocionet e live-t. Festivali i Këngës në RTSH zgjedh këngën përfaqësuese të Shqipërisë për në Festivalin Europian dhe duket se edhe këtë vit konkurrenca do të jetë e fortë. Në një intervistë për mediat ditë më parë, këngëtarja konkurrentja Eranda Libohova ka treguar për jetën e saj personale, profesionale dhe për planet e së ardhmes. Gjatë intervistës, ajo ka zbuluar një sekret duke u shprehur se ka vendosur që të rikthehet në festivale dhe se ka shumë dëshirë të këndojë 'live'. Eranda i mungon skenës së "Festivalit të Këngës në RTSH" prej 17 vjetësh.

"Kam një sekret të cilin po e ndaj për publikun. Unë kam dëshirë të marrë pjesë në festivalin e këngës. Më pëlqen të këndoj 'live' dhe e dua skenën, orkestrën dhe mendoj se do të rikthehem, jo sepse dua 'Eurovizionin', por sepse e dua muzikën", është shprehur Eranda.



INIS GJONI: Po rikthehem me shfaqje të re teatrale

Ka vite që nuk shoh asnjë program ose film në televizion, përjashtoj rastet kur marr ndonjë porosi nga miqtë dhe familjarët. E vetmja gjë që më merr vëmendjen nga ekrani janë kukullat e Coco-së dhe dokumentarët. Këto të fundit, mund t'i shoh për orë të tëra dhe të mos mërzitem. Jam një gjumashe e pandreqshme

Koha Blerand REXHEPI

Inis Gjoni është një nga femrat më të njohura të skenës shqiptare e përfshirë edhe në skandale, mirëpo e pamposhtur dhe e rikthyer disa herë në skenë jo vetëm si këngëtare, por si aktore dhe regjisore.

"Nuk bëj palestër, por një herë në ditë, i ngjis shkallet në këmbë deri në shtëpi. Dhe unë e kam shtëpinë në katin e tetë. Nëse nuk do isha marrë me art, do vdisja të bëhesha arkeologe ose shkencëtare. Më pëlqejnë shumë zbulimet", thekson kështu Inisi, duke shtuar se nuk sheh asnjë program televiziv ose film, por me rastet kur i rekomandohet nga dikush. "Ka vite që nuk shoh asnjë program ose film në televizion, përjashtoj rastet kur marr ndonjë porosi nga miqtë dhe familjarët. E vetmja gjë që më merr vëmendjen nga ekrani janë kukullat e Coco-së dhe dokumentarët. Këto të fundit, mund t'i shoh për orë të tëra dhe të mos mërzitem. Jam një gjumashe e pandreqshme... Do jepja gjithçka që të flija gjumë në mëngjes, por që prej lindjes së Coco kam kohë që nuk e di se ç'do të thotë të flija gjumë deri në orën 10. Maksimumi që kam arritur, ka qenë 9-ta (qesh)", thotë një nga femrat që gjithmonë ka thyer tabu në skenën shqiptare.

Ajo është e njohur edhe si balerinë, moderator e drejtuese festivalesh. "Kam thyer këmbën kur kam qenë 5 vjeçe dhe doktori në spital tha: sa të drejta i paska këmbët, nëse edhe këmba që ka thyer do të bëhet kaq e drejtë sa këmba tjetër, atëherë këtë vajzë bëheni balerinë. Atëherë askush nuk e dinte që unë do merresha me balet. Kam shumë histori nga jeta si balerinë, më ka ndodhur që më ka dalë këpuca gjatë kërcimit, që partneri ka këputur mish duke më ngritur në padjeshtë, e të tjera si këto. Kur mbarova shfaqjen e parë si regjisore, isha aq shumë e emocionuar sa nuk i njihja njerëzit që takoja. Ka qenë një rast kur drejtoja Festivalin e Këngës, së bashku me mikun tim Gaz Gjoka, që harrova pjesën time të tekstit dhe nisa të flisja 'përçart' për të dalë nga situata. Nuk e mbaj mend çfarë kam thënë, por këngëtarja e kuptoi që ishte radha e tij (qesh)".


Besoj, thotë ajo, kam qenë ndër të parat vajza në Tiranë që kam drejtuar një automjet, në vitin 96. "Unë dhe Rudina Magjistari, kemi qenë ndër të parat. Çmenduria më e madhe që kam bërë në timon, kam kaluar Llogaranë, natën dhe me mjegull. Zoti ka qenë me mua atë natë. Kam refuzuar mbi 10 oferta për të qenë në ekran vitet e fundit, nuk e di ç'më ka gjetur, por besoj se dashuria për teatrin po më mban larg televizionit. Si për fund, po ju zbuloj që aktualisht po punoj për një shfaqje të re teatrale", përfundon mes tjerave në rrëfimin e saj regjisorja e njohur Inis Gjoni.

MË POSHTË LISTA E PLOTË E PJESËMARRËSVE:

1. Aurel Thëllimi: Të dua ty
2. Bojken Lako: Jeto jetën
3. Bruno Pollogati: Nuk ka stop
4. Dilan Reka: Karma
5. Eliza Hoxha: Pengu
6. Elona Islamaj: Në këtë botë kalimtare
7. Elton Deda: Qetësisht
8. Eranda Libohova: 100 pyetje
9. Gjergj Leka: Besoj
10. GR. Alar: Dashuria nuk mjafton
11. Jonida Maliqi: Ktheju tokës
12. Kelly: A më ndjenë
13. Klint Çollaku: Me jetë
14. Klodiana Vata: Mbrëmje e pafund
15. Kujtim Prodani: Babela
16. Lidia Lufi: Rrëfhem
17. Lorela Sejdi: Vetmi
18. Marko Strazimiri & Leyla Imbro
19. Mirud: Nënë
20. Orgesa Zaimi: Hije
21. Soni Malaj: Do vij
22. Vikena Kamenica: Natën e mirë.

GAZMEND KELMENDI

PSE E SOLLA NË TREG PROJEKTIN “TRADITA” KU SHFAQEM ME GJYSHIN, BABAIN DHE DJALIN



KELMENDI: Sapo kam përfunduar disa kolazhe me këngë dasmash të cilat do i shfrytëzoj për xhirimet e fundvitit, poashtu do hedh në treg një këngë të re që është baladë nga fundi i muajit nëntor.

KOHA: Dasmat janë gjithmonë pjesë e jetës tënde, si e zhvillon një program artistik?

KELMENDI: Po zakonisht jam shumë i angazhuar në dasma gjatë tërë vitit si në Suedi ashtu edhe në Kosovë e Maqedoni.

KOHA: E dimë që ke një djalë, a mendon për zgjerim të familjes?

KELMENDI: Po, djali im Alteo i cili është 5 vjeç. Po patjetër, por jemi duke pritur lejlekun (qesh).

KOHA: Sa xheloze është bashkëshortja duke e ditur që tashmë ke një armatë simpatizantesh?

KELMENDI: Për fat të mirë nuk është aspak xheloze, të paktën mua nuk më shpreh atë (qesh), por jam me fat që e kam sepse pa mbështetjen e saj nuk do ia dilja dot.

Një nga emrat më të mirë të muzikës live që nuk ndalet brenda një viti është edhe këngëtari kosovar Gazmend Kelmendi-Gaza, i cili sapo ka hedhur në qarkullim projektin e titulluar “Tradita” një këngë e bukur ku në videoklip ai shfaqet me gjyshin, babain dhe djalin e tij. Për më shumë, në intervistën për shtojcën INFRARED të gazetës KOHA flet këngëtari Klemendi

lodhem duke kënduar nëpër ahengje të ndryshme, derisa e shoh nuk mund të jap maksimumin tim në skenë.

KOHA: Sa projekte numëron deri më tani Gazmendi?

KELMENDI: Kam realizuar dhjetë këngë, kurse tetë prej tyre janë realizuar edhe me videoklip.

KOHA: Jeton në Suedi po karrierën kryesisht e zhvillon në trojet shqiptare, sa të vështirë e ke këtë?

KELMENDI: Është pak e vështirë, por me vullnet po ia dal.

KOHA: Ke menduar të shfaqesh në ndonjë festival?

KELMENDI: Dëshirë kam, por projektet tjera më kanë marrë kohën dhe nuk kam mund t’ia dal mbanë, por ndoshta brenda vitit të ardhshëm mund të shfaqem në ndonjë festival.

KOHA: Cilat janë planet që je duke përgatitur deri në fundvit?

Koha Bisedoi: Blerand REXHEPI

KOHA: Je rikthyer pas një sezone të ngjeshur me një klip kushtuar traditës tonë, aty shfaqesh me gjyshin, babain dhe djalin, nga kjo ide?

KELMENDI: Pasi jemi katër breza me këtë rast kam dashur të shpreh traditën tonë shqiptare, da-

shuria për familjen si dhe për atdheun të cilin e trashëgojmë brez pas brezi.

KOHA: Je një nga emrat më të kërkuar të muzikës live, nga e merr gjithë këtë energji dhe deri kur mendon të vazhdosh?

KELMENDI: E kam gjithë këtë energji, sepse e kam pasion këndimin dhe nuk më duket vetja q

SHOTA BARALIU

HOQA DORË NGA MUZIKA, RIKTHEHEM FUQISHËM SI AKTORE

Ndonëse e diplomuar në aktrim Shota Baraliu gjithmonë ka qenë aktive në muzikë, edhe pse ka pauzuar dhe ka qëndruar për një kohë jashtë Kosovës, ajo do të rikthehet përsëri në ekran me një projekt që e ka lënë në gjysëm para dy vite e gjysëm por tashmë atë nuk do e shohim si këngëtare por vetëm si aktore.

KOHA: Arsyeja pse je larguar nga jeta aktive për momentin?


Po është e vërtetë që jam larguar nga skena tash e dy vite, por kisha arsye gjithmonë sepse shumicën e kohës nuk kam qenë në Kosovë.

KOHA: Cilat janë aktivitetet me të cilat merresh tani?

Pas shumë kohëve pushim që kisha, po mundohem të kthehem me një projekt që e kam nisur para dy vite e gjysëm.

KOHA: Dikur ishe shumë aktive në muzikë dhe aktrim, projektet që je duke punuar?

Muzikës i kam dhënë fund me kohë, aq ishte, e kam bërë thjeshtë për hobi



dhe asgjë më shumë, e me aktrim do jem më e pranishme.

KOHA: Ku e gjen më mirë veten? Në aktrim gjithmonë sepse e bëj me shpirt.

KOHA: Jeta private është gjithmonë caku që ju intereson më së shumti lexuesve, cili është statusi i Shotës dhe a ka ndonjë gjë të re në këtë drejtim?

Pas ndarjes nga i fejuari që kisha tani për tani jam single dhe as nuk më

shkon mendja njëherë për mashkull sepse u zhgënjeva pak.

KOHA: Këngët i ke pasur gjithmonë që kanë thyer temat tabu, a mendon të vazhdosh me të njëjtin ritëm?

Me të njëjtin ritëm do vazhdoj me një projekt që e kam filluar ta bëj, aty do jem tamam Shota origjinale pa komplekse dhe gjithmonë me gjëra për të qeshur. (B.R)





EDI KADRIJA DUA T'I TREGOJ BOTËS PËR SUKSESIN E SHQIPTARËVE

I ri dhe shumë i pashëm, një djalë që i është futur ndeshjeve të boksit me shumë seriozitet. Edi Kadrija është nga një fshat i Komunës së Junikut, por që jeton në Gjermani dhe ka shkuar atje si katër 4-vjeçrë. Në një intervistë për shtojcën INFRARED të gazetës KOHA, Edi rrëfen se për momentin është i fokusuar kryesisht në sportin që e kultivon dhe nuk ka ndonjë femër në krah

Koha

Bisedoi: Blerand REXHEPI

KOHA: Emocionet para ndeshjes dhe momenti që ke mësuar kundërshtarit?

Emocionet para luftës janë shumë normale e di që bëj e atë e ndjek e unë bëj stërvitje nga 3-4 orë në ditë dhe dua të bëhem kampion që të tregoj botës se kush jam e sa mundem të mbërrijë.

KOHA: A ke pasur frikë ndonjëherë?

Për frikë ose ndonjë gjë një boksieri që bën stërvitje secilën ditë dhe ndjek perspektivat e vjetra nuk ka frikë, ka më shumë respekt ndaj kundërshtarit është frikë më shumë nëse bën më pak se sa duhet, motori është që të tregohet botës kush je dhe si e bën luftën, jam i përgatitur gjithmonë.

KOHA: Mendimi që ju ka ardhur në kokë në momentin kur jeni shpallur fitues në ndonjë ndeshje?

Boksieri i vërtetë që e do ndonjë gjë ka shumë zemër dhe emocione sepse boksi të jep emër që të jesh dikush dhe duhet të mbash atë dhe me u mat me ma të mirët në botë. Herën e parë që kam fituar në boks profesional jam gëzuar shumë sepse e kam ditur që mund të bëj gjithmonë më shumë në këtë sferë.

KOHA: A e keni menduar ndonjëherë humbjen?

Një progres që nuk e blenë me të holla, sepse duhet të fitosh vet, sa më shumë të jep fuqi Zoti je vetvetja e kundërshtarit, sepse tek unë nuk vjen askush të më thotë "bëj stërvitje", sepse duhet të shkoj vetë se konkurrenca është shumë e madhe pasi ka gjithmonë boksier të fuqishëm.



KOHA: Cilat janë synimet tuaja pas ndeshjeve?

Synimet e mia janë që tash pas dy luftëra që do bëj të kem më shumë emër në Gjermani, por edhe në mbarë botën dhe të prezantoj shqiptarët sa më mirë.

KOHA: Çfarë i rekomandoni të rinjtë të cilët duan të merren me këtë sport?

Gjeneratat e reja dhe djemtë e rinj mund të them se boksi është sporti më i mirë në botë, sepse nuk është vetëm të rrihesh por të jep karakter në jetë dhe bëhesh më ndryshe në jetë, të ndihmon shumë në disiplinën private dhe në sport.


KOHA: Kush është Edi jashtë ringut?

Unë jam Edi Kadrija nga Komuna e Junikut, Edi flet me gjithë njësoj dhe nuk bëj krahasime i dashur për të gjithë. Nuk jam


boksier që bie poshtë e lartë, por unë hy në ring dhe rrihem vërtetë e nuk dua të më prek në boks, por nëse humbi ose fitoj - nuk ka lidhje, por kur rrihem unë është big drama shou, pasi ka shumë boksierë që bëjnë filma në ring.

KOHA: Kryesisht femrat e famshme duan të lidhen me meshkuj të fuqishëm, a ke në krah ndonjë bukuroshe?

Jam single që gjashtë muaj dhe normal që kërkoj dhe shoh, por nuk kam shumë kontakte me femra, sepse stërvitja dhe puna e jeta e pushimi, gjumi nuk më jep shumë kohë, andaj duhet të kem një femër që i kupton këto gjëra. Ka interese shumë, por nuk e kam mendjen njëherë aty, ndoshta vjen momenti dhe marrohem menjëherë (qesh).



49-vjeçarja Xhenifer Lopez me veshjen "pelerinë"



49 vjeçarja Xhenifer Lopez mahnti publikun me një fustan "pelerinë" Valentino Haute Couture, pa asgjë tjetër në trup - përveç diamanteve. Fotoja u shfaq në kopertinën e "Instyle", ku Lopez thotë në një intervistë se imazhi i trupit të saj ka ndihmuar që të pranohen më shumë format e mbushura. Pavarësisht stilit të sofistikuar, Lopez këmbëngul se ajo është ende njeri i thjeshtë, apo "Jenny from the block". "Edhe sot vazhdoj të mbaj vathë me rrrathë të mëdhenj dhe stoli floriri. Më pëlqen ta përziej madhështinë e stolive me stilin e lagjeve të thjeshta", thotë ajo.



XHESIKA NDOJA MUZIKËN NUK E NDËRROJË ME ASNJË GJË

Koha Bisedoi: Blerand REXHEPI

U bë shumë e njohur falë projekteve të saja muzikore dhe linjave fizike që ka, Xhesika Ndoja këngëtarja nga Shqipëria ishte edhe pre e thashethemeve të shumta të cilat mbajtën emrin e saj të përfolur thuajse në secilën media, e për këtë shkak ajo vendosi të largohet paksa nga vendlindja për të qëndruar në një qetësi absolute jashtë vendit, mirëpo ky muaj do e rikthejë atë me dy projekte muzikore, ndërkohë që në këtë intervistë për shtojcën INFRARED të gazetës KOHA, këngëtarja flet më shumë.

KOHA: Kohëve të fundit je zhdukur dhe nuk je shumë aktive në media, pse?

Po e vërtetë që jam larguar pak nga mediat pasi kam dashur vetë të distancohem sepse u mërzita duke e parë veten në secilën gazetë.

KOHA: Të ka penguar fama këto vitet e fundit?

Fama më ka penguar por edhe e kam shijuar këtë në privatësi.

KOHA: Cilat janë

projektet në të cilat po punon?

I kam dy projekte që do të realizohen shumë shpejtë, njëra nga këngët do jetë një duet.

KOHA: Je zhvendosur për momentin jashtë Shqipërisë, pse?

Nuk është se jam zhvendosur por kam preferuar të jem pak larg vendit tonë dhe me koncerte më shumë në diasporë.

KOHA: Cilat janë raportet me kolegët që mban, takohesh në kafe apo thjeshtë vetëm nëpër koncerte?

Raportet mirë i kam edhe pse me shumë tani më lidh puna e koncerteve se sa një kafe, në kohën e lirë për shkak se atë ia kushtoj më shumë vajzës time.

KOHA: Cili është fitimi më i lartë që ke pasur në muzikë deri më tani?

Në muzikë ka shumë fitim, por fitimi më i lartë për mua ka qenë aq sa kam dashur unë (qesh).

KOHA: Do e ndërroja këtë profesion për ndonjë drejtim tjetër?

Nuk do e ndërroja këtë profesion pasi e dua shumë, por do doja të kem edhe një profesion të dytë.

KOHA: Ke sprovuar veten në aktrim apo modelizëm?

Vetën e kam sprovuar dhe kërkesat kanë qenë shumë për modelim dhe aktrim, por koha ime e limituar nuk ka mundur të përballojë gjithë këtë agjendë.



KOHA: A e ka fituar dikush zemrën e Xhesikës?

A e ka fituar kush zemrën e Xhesikës (qesh), nuk e di por rëndësi ka që jam mirë.

Vetën e kam sprovuar dhe kërkesat kanë qenë shumë për modelim dhe aktrim, por koha ime e limituar nuk ka mundur të përballojë gjithë këtë agjendë

Një emër shumë i njohuri skenës shqiptare, një këngëtare që gjithmonë punon dhe viti nuk i mjafton për të publikuar projektet dhe për të përmbushur agjendën e saj. Rovena Stefa vjen në një rrëfim për shtojcën INFRARED të gazetës KOHA duke treguar kështu mbi projektin e fundit të cilin ia dedikon dashurisë, një fabul që nis si një dashuri në shikim të parë, në një klub e në një lokal siç thotë këngëtarja

KOHA: Ke pasur një agjendë të stërngarkuar këtë vit, sa e kënaqur je nga vetja?

Po, ka qenë një verë shumë e ngarkuar me plot punë, koncerte, dasma, evente e pushime. Kam qenë kudo nëpër diasporë, Shqipëri, Maqedoni e Kosovë për të qenë sa më afër fansave të mi e dashamirëve të muzikës time, jam kënaqur tej mase me pritjen që kam marrë prej tyre dhe sapo të

ROVENA STEFA

NUK JAM REALIZUAR NË TËRËSI, JU TREGOJ PROJEKTIN E FUNDIT QË I KUSHTOHET DASHURISË

publikoj klipin e ri menjëherë do të vazhdoj me mbrëmjet në diasporë e kështu shpresoj që me këtë energji të mirë të festojmë dhe festat e fundvitit.

KOHA: Me cilat projekte do prezantohesh deri në fundvit?

Kam videon e re "Jeta jeta" e cila del këtë fundjavë, pastaj pas një muaji besoj është projekti i ri gati gjithashtu edhe një potpuri na pret për festat e fundvitit.

KOHA: Je një nga emrat që thyen tabu dhe nuk ke komplekte, nga gjithë kjo energji e Roventës?

Unë nuk kam dëshirë të qëndroj pas zgjedhjeve të vjetra e të paplota që shoqëria ka bërë në të kaluarën, nëse dikush në të kaluarën ka caktuar disa rregulla kjo ndodh sepse ai ashtu e ka parë në

atë kohë, tani unë e shoh një gjë sipas këndvështrimit tim e rrethana të mia dhe kështu më pëlqen të arsyetoj, po ashtu më pëlqen të jem krijuese e jo të ndjek krijimet e të tjerëve, në fund të fundit një artist kështu dallon nga një joartist, nga forca për të krijuar e thyer të vjetrën.

KOHA: Kënga e fundit kujt do i dedikohet?

Dashurisë, si çdoherë.

KOHA: Fabula e këngës flet për..?

Dashurinë e dy të rinjve, dashurinë e shpenguar që ndodh papritur në një klub, në një bar ashtu si padashje. Aty fillon si një komedi për tu shndërruar në një dashuri.

KOHA: Je e kënaqur nga gjithë këto projekte që ke reali-

zuar?

Padyshim, por nuk kam mbaruar akoma.

KOHA: Nuk të kemi parë moti kohë në ndonjë duet, një emër i preferuar..?

Ka pasur duete, së shpejti mund të ketë ndonjë gjë të re.

KOHA: Në trend janë bashkëpunimet me reper, ka në plan një të tillë edhe Rovena?

Kam pasur edhe bashkëpunime me reper, dhe përsëri mund të ketë.

KOHA: Ku do të shohim pas 10 vitesh?

Do e shohim, as unë nuk e di. (B.R)



MBLEDHJA E PËRBASHKËT SHQIPËRI-KOSOVË SË SHPEJTI NË PEJË

Përmes programeve të bashkëpunimit ndërkufitar, falë ndihmës së BE-së, krijohet një mundësi dhe ndërlihdje jo thjesht mes dy zonave të ndryshme të Shqipërisë dhe Kosovës, por mbi të gjitha mes popullatave që jetojnë në këto zona e krahina, të cilat në rastin e Shqipërisë dhe Kosovës, ka një specifikë të veçantë, sepse, sipas tij, në fund të ditës jemi një komb dhe flasim një gjuhë.



Mbledhja e ardhshme e përbashkët mes dy qeverive Kosovës dhe Shqipërisë do të mbahet në Pejë. Lajmi u bë i ditur nga ministri i për Evropën dhe Punët e Jashtme i Shqipërisë, Ditmir Bushati.

“Në pak javë në do të kemi takimin e radhës mes qeverisë së Kosovës dhe Shqipërisë, që do të mbahet në Pejë, ku temë e diskutimit do të jetë edhe nevoja për lehtësimin e mëtejshëm për sa i përket bashkëpunimit ndërkufitar, për të krijuar më shumë lehtësi në këtë drejtim” u shpreh Bushati dje nga qyteti i

Kukësit.

Në përgjigje të zërave në Ballkan, të cilat ministri i cilësoi nacionaliste, ai tha se “ndërkohë që në Ballkan vijon të flitet për teza nacionaliste, ne shqiptarët është mirë që të fokusohemi në çështje sa më konkrete, të cilat ndikojnë jetën e qytetarëve”.

Sipas ministrit, përmes programeve të bashkëpunimit ndërkufitar, falë ndihmës së BE-së, krijohet një mundësi dhe ndërlihdje jo thjesht mes dy zonave të ndryshme të Shqipërisë dhe Kosovës, por mbi të gjitha mes popullatave që jetojnë në

këto zona e krahina, të cilat në rastin e Shqipërisë dhe Kosovës, ka një specifikë të veçantë, sepse, sipas tij, në fund të ditës jemi një komb dhe flasim një gjuhë.

3 programet e financuara nga BE-ja janë: pika doganore Shishtavec-Krushevë, mbrojtja mjedisore dhe menaxhimi i mbetjeve, si dhe programi i shtrirjes së vijës Dinarika, që ka të bëjë më rajonin ndërkufitar Shqipëri-Kosovë.

Duke prekur procesin e anëtarësimit në BE, kjo e fundit sipas tij është proces që fillimisht

nis me ndryshimin e dinamikës së komuniteteve lokale.

“Anëtarësimi në Bashkimin Evropian nuk është një proces që ka të bëjë me zbatimin e Reformës në Drejtësi, nuk është një proces që ka të bëjë me luftën kundër krimit të organizuar, të flasim edhe për tema që janë shumë konkrete dhe përmes disa projekteve konkrete, por domethënëse të ndryshojmë pak nga pak dinamikën e komuniteteve të ndryshme lokale”, tha ndër të tjera ministri./Ora NEWS

KONGRESMENËT AMERIKANË I SHKRUAJNË POMPEOS



Kjo është kërkesa e tyre për dialogun Serbi – Kosovë

Tetë kongresmenë amerikanë i kanë dërguar një letër sekretarit të përgjithshëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mike Pompeo në lidhje me bisedimet mes Serbisë dhe Kosovës. Tetë kongresmenë amerikanë kanë kërkuar nga sekretari i përgjithshëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mike Pompeo të ofrojë mbështetje për përpjekjet e Serbisë në arritje të paqes, nëpërmjet bisedimeve në kërkim të përmirësimit të raporteve me Prishtinën, shkruan “RTS”. Kongresmenët në letrën e tyre dërguar Pompeo kanë theksuar se një veprim i tillë diplomatik jo vetëm se do të ofrojë mundësinë për arritjen e paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm në Ballkan, por edhe njëherë do të dëshmojë vendosmërinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për siguri transatlantike. “Iniciativa e Serbisë për pajtim me Kosovën jo vetëm se është dëshmi se marrëveshja është në ardhje, por edhe ofron mundësinë për sigurimin e integritetit në komplet regjionin e Ballkanit dhe shtetet perëndimore”, thuhet në letrën e kongresmenëve të dërguar tek Pompeo. Ata po ashtu apelojnë nga Pompeo të vazhdojë të ofrojë mbështetje për përpjekjet e tilla, që sipas tyre, janë dëshmi e punës për arritjen e paqes dhe sigurisë në komplet regjionin e Ballkanit. Kongresmenët amerikanë theksojnë se është në interes nacional të Shteteve të Bashkuara të Amerikës të përkujdeset që bisedimet mes Beogradit dhe Prishtinës të kenë sukses dhe shtojnë se është imperativ për SHBA-të të mbikëqyrin marrëveshjet mes të dyja palëve në mënyrë që të arrihet një pajtim i plotë në përputhje me procesin e Brukselit.

Serbia jep dritën e gjelbër për investime te serbët e Kosovës

Mbi 200 milionë euro pritet të jetë kostoja e projekteve që do t'i investojë Serbia në Kosovë e për të cilat do të diskutojnë në Beograd, të martën, përfaqësuesit serbë të komunave me shumicë serbe të Kosovës, si dhe përfaqësuesit të të ashtuquajturave organe të përkohshme (komunat paralele) në takim me Qeverinë e Serbisë, shkruan Gazeta “Zëri”.

Të martën në Beograd do të takohen qeveria e Serbisë, përfaqësuesit serbë të komunave



me shumicë serbe dhe përfaqësuesit të të ashtuquajturave organe të përkohshme (komuna

paralele), ku do të diskutohet për pakon e ndihmave ekonomike për mjediset serbe, një

premtim të cilin presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiq ua ka dhënë serbëve gjatë vizitës së tij në veri të Kosovës.

Mbi 200 milionë euro pritet të jetë kostoja e projekteve që do t'i investojë Serbia në Kosovë e për të cilat do të diskutojnë në Beograd, të martën, përfaqësuesit serbë të komunave me shumicë serbe të Kosovës, si dhe përfaqësuesit të të ashtuquajturave organe të përkohshme (komunat paralele) në takim me qeverinë e Serbisë.



PANGALOS PËR KAÇIFAS: DUHEJ VRARË SEPSE KISHTE ARMË

Në Greqi vijojnë protestat për rastin në fjalë. Policia helene i është përgjigjur me gaz lotësjiellës një proteste në veri të vendit

Teodor Pangalos, ish-ministër i Jashtëm i Greqisë është shprehur në mbështetje të reagimit të forcave RENE në rastin e përplasjes me armë me Konstandinos Kacifas. Ndërkohë, mediat greke akuzojnë autoritetet shqiptare se po pengojnë hetimet për këtë çështje.

Ish-ministri i jashtëm i Greqisë nga radhët e PASOK, Teodor Pangalos, duke folur në një emision të televizionit “Ska” ka komentuar veprimet e forcave RENE për rastin e vrasjes së minoritarit Konstandinos Kacifas në Bularat të Gjirokastrës. Ai

u shpreh në mbështetje të reagimit të forcave ligjzbatuese shqiptare.

Teodor Pangalos: “Ai kishte armë apo jo? Unë jam i mendimit se diku sh që ka armë duhet të qëllohet nga policia, siç ndodh në Shtetet e Bashkuara të Amerikës apo në vende skandinave. Ky i ri shkoi për të vendosur flamurin grek. Unë kam parë në internet fotografi nga Bularati dhe rrugët janë plot flamuj grekë. Nuk e kuptoj këtë që thonë se nuk e lejuan të vendosi flamur. Nuk e kuptoj se çfarë donte ai të shkonte nga

Greqia të vendoste flamuj aty?”.

Ndërkohë, mediat greke kanë ngritur akuza ndaj autoriteteve shqiptare duke shkruar se po pengojnë hetimet për vrasjen e 35-vjeçarit Kaçifas. Protothema thekson se po ndryshohen provat. Një tjetër fakt i ri që zbulohet nga kjo media është fakti që Kaçifas ishte thirrur nga policia shqiptare ditë përpara se të ndodhte ngjarja. Kështu të paktën pretendojnë familjarët e tij që tregojnë se autoritetet i kërkuar shpjegime për vendosjen e flamujve grekë në zonë. Ky zhvillim është

përceptuar si kërcënim nga prindërit dhe motra e Konstandinos Kaçifas, të cilët kanë denoncuar këto fakte, sipas Protothemës, në një zyrë të policisë greke në doganën e Kaka-vijës.

Ndërkaq, avokati i familjes Kaçifas ka treguar për mediat greke se gjatë inspektimit të trupit të pajetë në morg ka parë dy dëmtime në zemër dhe asnjë shenjë tjetër. Në Greqi vijojnë protestat për rastin në fjalë. Policia helene i është përgjigjur me gaz lotësjiellës një proteste në veri të vendit./abcnews.al

UNIVERSITETET AMERIKANE MORËN 350 MILIONË DOLLARË NGA ARABIA

Kolegjet dhe universitetet amerikane morën më shumë se 350 milionë dollarë nga Qeveria saudite në këtë dekadë, sipas analizës së agjencisë amerikane Associated Press (AP).

37 shkolla amerikane, nga viti 2011 deri 2017, morën të paktën 354 milionë dollarë fondesh nga qeveria saudite ose institucionet nën kontrollin e Riadit.

Shumica e këtyre parave janë siguruar përmes një programi të bursave që mbulon shkollim për studentët sauditë në SHBA, por



të paktën 62 milionë dollarë dhuratave të kompanive saudite erdhën përmes kontratave apo shtetërore dhe institutet kërki-

more, shkruan AP.

Megjithatë, pas vrasjes së gazetarit saudit Jamal Khashoggi, disa shkolla filluan të marrin në konsideratë kontratat aktuale dhe ato të ardhshme.

AP analizoi të dhënat nga raporti i Departamentit të Arsimit të SHBA "Dhuratat e Jashtme dhe kontratatave", i cili përmban të dhëna mbi financimet e huaja të secilit prej universiteteve amerikane që kanë marrë 250.000 dollarë ose më shumë në një vit të vetëm.



Trump në lupën e një prej gazetarëve

të Watergate

Bob Woodward, një prej gazetarëve amerikanë, zbulimet e të cilit mbi skandalin e Watergate kanë detyruar presidentin Nixon të japë dorëheqjen, po sulmon mënyrën e qeverisjes së presidentit amerikan, Donald Trump në veprën e tij të fundit.

"Fear: Trump in the White House", që del më 11 shtator, zbulon detajet e pazakonta për jetën e trishtë në Shtëpinë e Bardhë të Donald Trump dhe për mënyrën se si presidenti amerikan merr vendimet për çështjet e mëdha politike të jashtme dhe të brendshme, sipas edituesit "Simon & Schuster". Presidenca e Trump, nisur dy vjet më parë, është shënuar nga largimet e personaliteteve dhe skandalet përsa i përket shpenzimeve të panevojshme dhe të pabaza si pasojë e çështjes për një bashkëpunim të mundshëm me Rusinë gjatë fushatës zgjedhore.

Simbole të gazetarisë investigative, Bob Woodward dhe Carl Bernstein kishin ndërmarrë hetimin e Washington Post duke nisur nga viti 1972 për degëzimet për një çështje spiunazhi të partisë demokratike, ashtuquajtur Watergate. Zbulimet kanë detyruar presidentin, Richard Nixon të jepte dorëheqjen, në gusht 1974.

Libri i ri i Bob Woodward, 75 vjeç, i cili ka qenë gjithmonë pjesë e redaksisë së "Washington Post", është i fundit i një serie librash për presidentat amerikan, shkruar nga gazetari i njohur.

Zhduken 5 miliardë dollarë nga llogaria e Gaddafi

Pesë miliardë dollarë janë zhdukur nga llogaria e ish-liderit të Libisë, Muamar Gadafi, në Belgjikë. Lajmin e ka bërë të ditur prokuroria belge, që ka njoftuar gjithashtu hapjen e një procesi hetimor për të verifikuar nëse shuma e madhe ka përfunduar në duart e milicive apo partive politike në Libi. Autoritetet kanë akuzuar qeverinë në Bruksel se nuk ka respektuar vendimin e OKB-së në vitin 2011 për të ngrirë të gjitha asetet e Muamar Gadafit në

Belgjikë. "Përpara se të pllakosë skandali, qeveria duhet të sqarojë se çfarë ka ndodhur", ka deklaruar një prokuror. Ndërkohë, edhe Kombet e Bashkuara kanë njoftuar nisjen e një hetimi lidhur me zhdukjen e 5 miliardë dollarëve. Lideri i Libisë për disa dekada me radhë, Gadafi u rrëzua nga pushteti dhe u ekzekutua 7 vjet më parë, kur protestat e së ashtuquajturës Pranëveve Arabe u shtrinë edhe në vendin e tij./abcnews.al



Ushtria turke mësyn mbi bazat kurde, vret mbi 40 luftëtarë



Ushtria turke vrau mbi 40 militantë kurde në sulmet ajrore në Irakun verior gjatë ditës së sotme, ndërsa ata po përgatiteshin për të nisur një sulm në rajonet ku janë vendosur bazat turke, thanë autoritetet e Ankarasë ajo në një dekla-

ratë në Twitter. Po sipas deklaratës zyrtare të autoriteteve turke, gjatë sulmeve ajrore u shkatërruan edhe bazat e militantëve, si dhe një sërë stoqesh me municione, të cilat përdorshin nga luftëtarët kurde, për të sulmuar bazat turke.

Turqia në muajt e fundit ka kryer sulme në bazat e Partisë së jashtëligjshme të Punëtorëve të Kurdistanit (PKK), në Irakun e veriut, veçanërisht në kështjellën e tij në malet Qandil, ku Ankaraja gjithashtu ka kërcënuar të kryejë një ofensivë tokësore.

Më shumë se 40.000 njerëz janë vrarë që kur PKK filloi kryengritjen e saj në Turqi në vitin 1984, ndërsa 7 ishin vrarë edhe një ditë më parë, të martën. Kjo parti është caktuar një organizatë terroriste nga Turqia, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

"NATO arabe" përgatitet për stërvitjen e përbashkët në Egjipt

Forcat e armatosura dhe vëzhguesit nga tetë vende arabe po grumbullohen në Egjipt për ushtrimet e përbashkëta që pritet të fillojnë të shtunën, tha ushtria egjiptiane të mërkurën, në një lëvizje që mund të evoluonte në një pakt rajonal për të luftuar ndikimin e Iranit.

Administrata e presidentit Donald Trump ka nxitur në heshtje vendet e Gjirit të Arabisë, së bashku me Egjiptin dhe Jordaninë, që të fillojnë të bashkohen atë që disa zyrtarë të Shtëpisë së Bardhë e kanë quajtur "NATO arabe" të aleatëve myslimanë sunitë, për të kundërshtuar



pushtetin shiit të Iranit. Një koalicion i shteteve arabe të udhëhequra nga Arabia Saudite tashmë po ndërhyjnë në luftën e Jemenit, duke organizuar sulme ajrore

kundër forcave të Houthis, të lidhura me Iranin, të cilat kontrollojnë pjesën më të madhe të veriut të vendit, përfshirë kryeqytetin Sanaa.

Në një deklaratë në faqen e tij

në Facebook, zëdhënësi i ushtrisë egjiptiane tha se forcat ajrore, tokësore, detare dhe speciale nga Emiratet e Bashkuara Arabe, Arabia Saudite, Kuvajti, Bahreini dhe Jordania kanë filluar të vijnë në Egjipt për ushtrimet e quajtur "Mburoja e Arabëve 1", që do të mbahen nga 3-16 nëntori.

Përveç ushtrive të këtyre vendeve, stërvitja e përbashkët do të ndiqet hap pas hapi edhe prej vëzhguesve nga shtetet si Libani dhe Maroku, të cilët plotësojnë 8-shen e shteteve të së ashtuquajturës "NATO Arabe"./ Top Channel



Informacioni që ia mori jetën gazetarit Khashoggi pak

Gazetari që u vra në konsulatën saudite në Stamboll pak para vdekjes ka siguruar dëshmi të forta se ushtarët sauditë në Jemen po përdornin fosforin e bardhë kundër Hutive në Jemen.

Sipas të dhënave të reja, të cilat kanë "rrjedhur" nga qarqet diplomatike, gazetari saudit Jamal Khashoggi i cili para se është vrarë e copëtuar në konsulatën saudite në Stamboll, po planifikonte të botonte të dhënat se ushtarët sauditë kanë përdorur helme kimike në luftën në Jemen.

"Jam takuar me Khashoggin një javë para vrasjes së tij në konsulatë. Ishtë shumë i shqetësuar, më tha se ka siguruar dëshmi se Arabia Saudite ka përdorur fosfor të bardhë në luftërat kundër Hutive në Jemen", ka thënë njëri prej bashkëpunëtorëve të gazetarit, identiteti i të cilit ende nuk është bërë i njohur.

Të dhënat për këtë dëshmi i kanë marrë mediat iraniane e britanike, me kusht që të mos e zbulojnë emrin e tij dhe pozicionin e vërtetë, njoftojnë mediat.

TRE NET TË FESTIVALIT TË 57-TË TË KËNGËS NË RTSH

KËNGËTARËT, PERFORMANCË SI NË EUROSONG

Prezantimi i 22 artistëve do të bëhet përmes historive të krijuara posaçërisht për secilin prej tyre. Festivali nuk do të ndryshojë mënyrën e votimit, juria profesionale do të jetë ajo që do të votojë Këngën fituese, që do të çojë Shqipërinë në Festivalin Eurosong



dhjetorit, përmes rrjeteve sociale instagram dhe facebook, apo edhe përmes hapësirës televizive që do t'i kushtohet çdo mbrëmjeje në TVSH, këtij edicioni!

VOTIMI I TË RINJVE

Këngë që ngajnë me melosin shqiptar, këngë që janë origjinale, këngë që nuk janë të kopjuara, këngë që janë dinjitoze, këngë që një rini do t'i mbajë mend, këngë që do të bëhen hit. Atëherë një nga mënyrat si do t'i afrojmë në këto të rinj është krijimi i një jurie e të rinjve. 15 gjimnazet në Tiranë profesionale dhe jo, të zgjedhin 10 maturantët më të mirë, të cilët do të krijojnë një juri të re. Do të jenë këta 150 të rinj maturantë që do ndjekin festivalin dy net në Pallatin e Kongreseve dhe natën e fundit do të lokalizohen diku tjetër që të votojnë. Do të jepet një votë nga rinia për të kuptuar dhe trendin. Vota do të jetë shumë demokratike, do të përdoren për të votuar mjetet teknologjike. Festivali do të shkojë me mënyrën tradicionale me një juri profesionale, thonë organizatorët, por do të shikojmë një trend dhe ai që do të fitojë nga rinia nuk afron me brezin e ri dhe shijen e tij. Kjo formë është përzgjedhur që rinia të jetë pjesë e festivalit./Shekulli

Në ambientet e Radio Televizionit Shqiptar u prezantua nisja e punës për edicionin të 57-të të Festivalit të Këngës në Radio Televizionin Publik Shqiptar! Ekipi realizues i këtij edicioni përbëhet nga: Martin Leka (drejtori i Festivalit), Inva Mula (drejtoreshë artistike), Sokol Marsi (producent muzikor), Pandi Laço (skenarist) dhe Bledar Laço (regjisor)! Përveç këtyre, bashkë me kompozitorin Nestor Kraja, këta emra edhe komisioni që ka përzgjedhur 22 këngët që do të ngjiten në skenë të Pallatit të Kongreseve në datë 20-21 dhe 22 dhjetor. Platforma e këtij edicioni, sipas

stafit organizator, pretendon të jetë më i hapur se kurrë, duke afruar sa më shumë rininë. Objektiv është që të rikthejnë entuziazmin e Festivalit të Këngës në Radio Televizion drejt një publiku, i cili ndoshta për arsye të shumta është shkëputur. Në mënyrë që publiku kthejë vështrimin dhe të ketë dëshirën si diku ta ndjekë Festivalin në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit do të krijohet një grup me nxënës të mirë të 15 shkollave të mesme të Tiranës, të cilët do të ndjekin nga afër dhe do jenë një juri ekstra, që do të vlerësojë këngën më të mirë!

TRE NETËT E FESTIVALIT

Festivali nuk do të ndryshojë mënyrën e votimit, juria profesionale do të jetë ajo që do të votojë Këngën fituese, që do të çojë Shqipërinë në Festivalin Eurosong. Këngët do të prezantohen në 2 net, nata e parë në 20 dhjetor, ku 22 këngëtarët do të këndojnë 'live' me orkestrën Simfonike të Radio Televizionit Shqiptar, nata e dytë do të jetë Nata e Performancave, apo ndryshe Nata Eurosong, ku të 22 këngët do të vijnë të interpretuara 'live' por pa orkestrë, ato do të shoqërohen nga elementë spektakli duke dhënë në një mënyrë të

njëjtën paraqitje që çdo konkurent do të kishte në Festivalin Europian. Dhe në natën e tretë këngët do të konkurrojnë për vendin e parë. Këtë vit këngët do të prezantohen paraprakisht në një formë ndryshe, duke nxjerrë pakëz prej melodisë, refrenin apo bulëza kënge, por jo të gjithë materialin konkurrues, pasi ai është në garë dhe ethet e garës duhet t'i testojë 'live'. Prezantimi i 22 artistëve do të bëhet përmes historive të krijuara posaçërisht për secilin prej tyre, të cilat do të shfaqin momente pune apo edhe private dhe do të prezantohen në javën e parë të

DOKUMENTAR PËR GRATË SHQIPTARE

Historia e gruas shqiptare nga diktatura në kaosin e ndryshimit të sistemit e deri në ditët e sotme është një histori frymëzimi për shumë gra në botë. Një histori jo vetëm mbijetese por dhe emancipimi do të vijë përmes rrëfimeve të grave që me jetët e tyre kanë sjellë ndryshimin. Pas botimit të librit "Donne D'Albania".

Tra migrazione, tradizione e modernità", (Gra të Shqipërisë. Midis migrimit, traditës dhe modernitetit), përgatitur për botim nga sociologu Rando Devole dhe drejtori i revistës Confronti (www.confronti.net), Claudio Paravati, tashmë historia e grave shqiptare do të vijë në një dokumentar në vendin fqinj Italinë.

Dokumentari do të realizohet në bashkëpunim me Ground Vista Pictures e regjizorin Riccardo Bianco, fitues e çmimit të parë me dokumentarin e tij "Nicu" në festivalin Around Film Festival i Berlinit, i cili sapo ka mbaruar dokumentarin e fundit "Brucia la sabbia", xhiruar më 2017 në Siri.

Dokumentari do ndjekë nga afër situatën e grave në Shqipëri,



ri, për të kuptuar edhe akoma më mirë ato që jetojnë si migrante në Itali. Idea e këtij dokumentari lindi pas suksesit që pati botimi i librit "Donne D'Albania" në Itali. Libri u prezantua në shumë qytete italiane dhe pati një interes nga shumë lexues mbi historitë e tyre. Prezantimi i parë i këtij libri ishte në nëntor të vitit të shkuar në Tiranë ku morën pjesë shumë personalitete të kulturës.

Por dokumentari kërkon tu tregojë lexuesve historinë e vërtetë të gruas në Shqipëri. Një histori që do të vijë përmes rrëfimeve të shumë grave që me jetën e tyre kanë dhënë një kontribut në shoqëri, apo në të shkuarën.

Autorët e këtij dokumentari

do të gjejnë të gjitha ato femra që janë model suksesi nga veriu në jug të vendit, apo dhe ato që jetojnë në Itali për të parë se si është tashmë jeta e një gruaje në një vend që ka jetuar një nga sistemet më totalitare në Ballkan. Skenari i dokumentari do të shkruhet nga dy kuratorët e librit Claudio Paravati edhe Rando Devole, ndërsa produzioni do kurohet nga Gerta Beqiri, një vajzë shqiptare që jeton në Itali për me shumë se dy dekada, por që gjithmonë ka kontribuar në mënyrë aktive për komunitetin shqiptar në Itali. Gerta është dhe një nga autorët e librit "Donne D'Albania" dhe punon si producente, kontabiliste për kompanin Ground Vista Pictures./Gazeta Shqip

Pulla postare me ansamblin "Shota"

Posta e Kosovës lëshon të premten në qarkullim emisionin e pullave postare 70 Vjetori i ansamblit të këngëve dhe valleve "Shota".

Ansambli kombëtar i këngëve dhe valleve "Shota" fillimisht është formuar si shoqëri amatore në vitin 1948, ndërkaq si ansambël i këngëve dhe valleve më 30 shtator 1950, që e bënte këtë ansambël njërin ndër institucionet e para artistike dhe kulturore në Kosovë.

Edhe pse qëllimi i themelimit të këtij ansambli ishte të ruajë trashëgiminë burimore kulturore në lëmin e këngëve dhe valleve popullore, si dhe të hulumtojë format e reja të përpunimit të artit popullor, për shkak të politikës diskriminuese ish-jugosllave, më 18 mars 1954 ndërpritet funksionimi i tij.

Me krijimin e kushteve, në mars

të vitit 1964, ky ansambël është rithemeluar me emërtimin Ansambli Shtetëror "Shota", i cili luajti një rol të pazëvendësueshëm në ruajtjen, kultivimin dhe zhvillimin e këngëve dhe valleve popullore të Kosovës. Ansambli "Shota" afirmoi vlera të mirëfillta kulturore kombëtare siç është origjinaliteti i kostumeve, meloditë autentike dhe vallet e veçanta ekzotike, me të cilat ky ansambël është prezantuar në më se 50 shtete të ndryshme të botës, në të gjitha kontinentet.

Nga viti 1994, ansambli funksionon me emërtimin e ri: Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve "Shota". Filatelia e Postës së Kosovës do të angazhohet që përmes imazheve të pullave postare të afirmojë vlerat tona kulturore dhe kombëtare.



SHKËNDIJA KOLEKSIONON FITOREN E SHTATË NË KAMPIONAT

OSMANI: TË VAZHDOJMË ME KËTË RITËM

“Tre fitore një pas një dhe kjo është shenjë e mirë për ekipin tonë dhe motiv që edhe në ndeshjet e ardhshme të luajmë në këtë ritëm dhe të vazhdojmë me fitore”, deklaroi Qatip Osmani

Shkup, 1 nëntor - Skuadra e Shkëndijës ka shënuar fitoren e shtatë në 12 ndeshje kampionale dhe vazhdojnë ndjekjen e pozitës së parë në renditje, që e mbanë Vardari me 27 pikë, ndërsa kuqezinjtë kanë vetëm dy pikë më pakë. Në takim të zhvilluar të mërkurën në Strumicë ishin Izair Emiri dhe Ennur Totre që shënuan golat në triumfin 2:0 ndaj Bellasicës, duke sjellë fitoren e tretë me radhë në kampionat. Trajneri i Shkëndijës, Qatip Osmani, është i lumtur me fitoren e radhe dhe me menaxhimin e lojës gjatë 90 minutave. “Tre fitore një pas një dhe kjo është shenjë e mirë për ekipin tonë dhe motiv që edhe në ndeshjet e ardhshme të luajmë në këtë ritëm dhe të vazhdojmë me fitore. Sa i përket ndeshjes mendoj se fituam me meritë, menaxhuam lojën mirë brenda 90 minutave. Pas kartonit të kuq të kundërshtarit patëm edhe disa raste shënimi, por megjithatë jemi të kënaqur me tre pikët dhe përgëzoj lojtarët për fitoren”, komentoi pas ndeshjes traj-

neri Qatip Osmani. Sipas teknikut kuqezi vendimtare për triumfin e sotëm ishte eksperiencia e futbollistëve për përballje të këtij lloji. “Ndikoi përvoja e disa futbollistëve që kemi në ekip për ndeshje të këtilla dhe ata dinë si ta menaxhojnë lojën në fushë. Edhe në këtë takim treguam se shkojmë në rezultat, në fitore dhe në këtë drejtim ndeshjen e menaxhuam shkëlqyeshëm”, tha Osmani që shton se tashmë skuadra duhet të punojë në ruajtje të kontinuitetit dhe freskisë gjatë orarit të ngjeshur. “Sigurisht se kontinuiteti i nevojitet çdo ekipi, pra rezultatet pozitive. Mirëpo në këtë moment është shumë e rëndësishme është të menaxhojmë freskimin e ekipit me një apo dy lojtarë në çdo ndeshje kur kemi orar të ngjeshur me ndeshje çdo fundjavë dhe mesjavë”, përfundoi trajneri kuqezi. Takimin e radhës Shkëndija do ta zhvillojë ditën e diel në stadiumin e qytetit të Tetovës, ndërsa do të pret ekipin e FC Shkupit.




De Biazi: Shqipëria, përvoja më e bukur për mua

Ish-trajneri i Kombëtares kuqezi, Xhani De Biazi, ka folur së fundi për “Il Milanista”, duke pranuar për të disatën herë se ishte shumë pranë stolit të Italisë. Ai ka folur më shumë për situatën te Milani, duke u shprehur se skema 4-4-2 i jep më shumë ekuilibër skuadrës së Gatzos, por ka prekur edhe temën e kombëtares italiane: “Milani nuk ka gjetur ekuilibër pas 10 javësh. Skema 4-4-2 ndaj Sampdorias i shkon për shtat Higuainin dhe Kutronen, që me skemat e mëparshme sakrifikohehin. Mendoj se Italia nuk ka shumë talente kohët e fundit dhe ky është një problem thelbësor. Kemi lojtarë të mirë, por që nuk kanë përvojë për ta udhëhequr kombëtaren. Italia e Maldinëve, Nestave, Totëve dhe Del Pierove nuk ekziston në këtë moment. Përvoja në stolin e Shqipërisë ishte ndër më të rëndësishmet për mua, pse jo më e rëndësishmja në jetën time profesionale. Kemi bërë diçka që në fillim askush nuk mund ta imagjinonte, shkuam në Euro 2016. Besoj se ka lindur gjithçka nga puna e bërë dhe nga vullneti i lojtarëve. Stoli i Italisë? Kur u zgjodh Ventura, kam qenë shumë afër deri në momentin e fundit për t'u bërë axurr, por gjërat morën rrjedhë tjetër. Ndodhi sepse Federata Shqiptare e Futbollit nuk donte të më lironte, por edhe sepse Ventura ishte zgjedhur. Isha shumë pranë. Tani dua të gjej një mundësi që të më pëlqejë. Kam refuzuar disa oferta që më kanë ardhur, mes tyre edhe kombëtaren e Armenisë”, ka thënë De Biazi.

Xhimshiti drejt largimit nga Atalanta

Mbrojtësi i kombëtares së Shqipërisë do të mbetet pjesë e elitës së futbollit italian. Berat Xhimshiti duket se po kërkon një ekip ku të mund të luajë më shumë. Mbrojtësi i përfaqësueses sonë është aktivizuar pak me Atalantën këtë sezon. Klubi i tij i ka ofruar rinovimin por duket se ai do të largohet. Sipas mediave italiane e interesuar për qendërmbrojtësin është Frosinone, e cila po lufton për të qëndruar në

Serie A. Përforcimi i mbrojtjes shihet si një mundësi më shumë për të qëndruar mes më të mirave për ekipin që mban vendin e 19-të në Serie A. Sipas të gjitha gjasave në janar Xhimshiti do të ndërrojë skuadrën. Kujtojmë se klubi nga Italia Atalanta zë vendin e pesëmbëdhjetë në ligën Serie A me një bilanc të dobët me vetëm 12 pikë në dhjetë ndeshje të zhvilluara këtë sezon.



Avdijaj dhe Zeneli shënojnë në Kupën e Holandës

Donis Avdijaj dhe Arbër Zeneli kanë shkëlqyer në Kupën e Holandës, duke shënuar dy gola, respektivisht një. Yjet e Përfaqësueses së Kosovë kanë qenë protagonist në fitoret e skuadrave të tyre. Donis Avdijaj ka kontribuar me dy gola në fitoren e Willem II ndaj Spakenburg. Willem II e fitoi këtë ndeshje 5:0, ndërsa Avdijaj shënoi në minutat 53' dhe 59'. Golin në Kupën e Holandës e ka gjetur edhe Arbër Zeneli. Zeneli ka shënuar në minutën e 49' në fitoren 1:3 të Heerenveen në udhëtim te Groene Ster.

Mbrojtja e Kosovës “çalon” për arsye jospportive

Mbrojtësi Loret Sadiku vazhdon të shprehë zhgënjimin në intervista të ndryshme që nuk po mund të përfaqësojë Kosovën. Ai është shëndosh e mirë dhe i gatshëm të luajë, por përfaqësimin e vendit prej nga vjen nuk ia lejon rregullorja e FIFA-s. Në të, si mbrojtësin më të mirë “në treg” tash për tash, Kosova kishte llogaritur shumë, por ende nuk është


dorëzuar plotësisht. Për çështje që nuk kanë të bëjnë me sportin, reparti i mbrojtjes i përfaqësueses së Kosovës po vuan mungesën edhe të një mbrojtësi tjetër, që ishte vlerësuar perspektiv - Bajram Jashanica. Edhe atë nuk po e lejon FIFA të luajë, madje as për klubin e tij, Skënderbeu. Derisa Sadikut nuk po i lejohet të luajë për Kosovën, me arsyetimin e FIFA-s se

tashmë ka bërë një ndërrim të përfaqësueses, nga Suedia në Shqipëri, Jashanica është i suspenduar për shkak të dopingut. Pak muaj i ka vuajtur dhe i ka mbetur edhe një vit e gjysmë. Kosova në ndeshjet e fundit ka pranuar pak gola, por edhe rivalët ishin të nivelit të saj apo më të dobët. Në rastin e parë kur iu paraqit një mungesë, mbrojtja ra



CAVANI, MË SHUMË SE NJË ËNDËRR E NAPOLIT

"Corriere dello Sport" tenton të zbulojë skenarin e shndritshëm për tifozët napoletanë. Pas ndeshjes PSG-Napoli, pranë dhomës së zhveshjes së bluve, pati një takim dhe shtrëngim duarsh midis Cavani dhe De Laurentiis. Uruguaiiani shkoi për të përshëndetur disa miq të vjetër dhe ish-shokët e skuadrës, para të cilëve nuk e ka fshehur dëshirën e kthimit në Napoli një ditë



Gattuso: Akoma nuk po luajmë si skuadër

Trajneri i AC Milan rino Gattuso ka thënë se Kuqezinjtë nuk janë duke luajtur akoma si skuadër, megjithëse fituan ndaj Genoa-s 2-1 të mërkurën. Milan mori kryesimin e ndeshjes që në fillim të takimit me Suso-n, por autogoli i Romagnoli-t barazoi gjithçka. Në fund të takimit ishte përsëri qendërmbrojtësi ai që shënoi, këtë herë në portën kundërshtare. Me këtë fitore Milan ngjitet në vend të katërt të renditjes së Serie A, por Gattuso duke folur për Sky Sport thotë se nuk po luajnë akoma si skuadër. "Kemi rikupëruar lojtarë të rëndësishëm, jemi ngjitur në renditje, por akoma nuk po luajmë si skuadër. Po shënojmë gola të mrekullueshëm, por duhet të përgëzojmë edhe Dinnarumma-n, i cili bëri një prite të pabesueshme kur rezultati ishte 1-1. "Një vend mes katër më të mirëve ishte hapi i parë, tani duhet të qëndrojmë aty. Duhet të vazhdojmë kështu pasi akoma nuk kemi arritur asgjë", ka theksuar Gattuso.

24 tetori i këtij viti do të kishte hyrë në histori si një datë e paharrueshme për Napolin, nëse fitorja e tij në "Parc des Princes", kundër PSG-së së frikshëm, nuk do të "hidhej në erë" në fund fare, nga një gol i Angel Di Maria. Edinson Cavani, nga ana tjetër, mbeti thatë: një provë që nuk "tërheq" shumë kundër të kaluarës së tij, e cila, ndoshta, mund të bëhet edhe e ardhmja. Në verë, më shumë se një herë, ai është kontaktuar nga klubi i presidentit Aurelio De Laurentiis, i cili ka gjithmonë iu është përgjigjur me shaka tifozëve, me këtë fjali: "Unë jam Cavani juaj". Presidenti napolitan e di mirë, megjithatë, se me një "Matador" në përbërje, Napoli do të përmirësohet poziti-

visht në shumë drejtime. Kjo, sepse bëhet fjalë për një nga sulmuesit më "vdekj-prurës" në Europë, në gjendje të shënonte 104 gola në vetëm tri sezona, në hijen e Vezuivit. "Corriere dello Sport" tenton të zbulojë skenarin e shndritshëm për tifozët napoletanë. Pas ndeshjes PSG-Napoli, pranë dhomës së zhveshjes së bluve, pati një takim dhe shtrëngim duarsh midis Cavani dhe De Laurentiis. Uruguaiiani shkoi për të përshëndetur disa miq të vjetër dhe ish-shokët e skuadrës, para të cilëve nuk e ka fshehur dëshirën e kthimit në Napoli një ditë, një qytet që i ka dhënë aq shumë në aspektin emocional dhe profesional. Për ta konfirmuar këtë vullnet të tij shërbeu edhe

ceremonia e "Golden Foot", çmim të cilin e fitoi: "Thashethemet për Napolin? Janë zëra, që më pëlqejnë". Cavani, kontrata e të cilit me PSG-në skadon në vitin 2020, duhet, megjithatë, t'i zvogëlojë dukshëm 12 milionë eurot, që fiton aktualisht në Paris, shumë e papërbalueshme për financat e Napolit, çka është sugjeruar në mënyrë të përsëritur nga De Laurentiis. Nga presidenti është konfirmuar se një kthim është i mundshëm, por vetëm në kushte të caktuara ekonomike. Paratë, nga të cilat do të hiqte dorë sulmuesi uruguaiian, do të kompensohen nga dashuria e madhe, që do ta kishte me shumicë në "San Paolo". Aty do të ishte i mirëpritur si një hero i vërtetë.

Publicitet

Në bazë të nenit 09, 16 alineja 3 dhe 17 nga Rregullorja për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënës dhe aktivitete tjera të lira për nxënësit e shkollave filllore, SHFK "Kire Gavriloski-Jane" Prilep, publikon:

SHPALLJE

Për zgjedhjen e ofertave për realizimin e ekskursioneve për nxënësit e klasave III, VI dhe IX dhe për nxënësit e klasës V për mësim në natyrë për vitin shkollor 2018/2019.

Kushtet minimale që ofruesi duhet ti plotësojë janë:

- të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në R. e Maqedonisë për kryerjen e veprimtarisë adekuate turistike;
- të ketë realizuar së paku 3 ekskursione të nxënësve me sukses dhe aktivitete tjera të lira në 3 vitet e fundit;
- të plotësojë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion dhe rrugë dhe Rregulloren për kërkesa të veçanta teknike të makinave me të cilat bëhet transporti i grupeve të fëmijëve.

Shpallja zgjat 5 ditë nga dita e publikimit.

Kushtet për realizimin e ekskursioneve për fëmijë, mësim në natyrë dhe programe tjera, mund të tërhiqen në hapësirat e shkollës në rr. "Joska Jordanoski" nr. 46 - Prilep

SHFK "KIRE GAVRILOSKI - JANE"
PRILEP

NJOFTIM

Afati për paraqitje për kandidatët e interesuar për regjistrim në trajnim profesional dhe përmirësim të aviacionit në akademinë Ushtarake "Gjeneral Mihajlo Apostolski" - Shkup, të personave me cikël të parë të mbaruar në studimet për nevojat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë, pas konkursit të publikuar më 03.09.2018 në gazetën ditore "Veçer" dhe "Koha", vazhdohet deri më 30.11.2018.

**Me nderime,
Akademia Ushtarake**



J.З.У. КЛИНИЧКА БОЛНИЦА Тетово I.P.SH. SPITALI KLINIK Tetovë
H.P.I. CLINICAL HOSPITAL TETOVO

Тел./Tel. 044/339 002 Факс./Fax. 044/335 925 Цент./Cent 044/330 810 Мехмет Паш Дerrала" 6.6. 1220 Тетово "Mehmet Pashë Derralla" p.n. 1220 Tetovë
E-mail: medcente@t-home.mk ; bolnicate@t-home.mk

Korrigjimi i Shpalljes publike për punësim

Në Shpalljen e publikuar për pranimin e punonjëseve shëndetësorë dhe bashkëpunëtorëve shëndetësorë në kohë të pacaktuar pune në IPSH Spitalin Klinik Tetovë nr. 04-2343/2 me datë 10.10.2018 v., publikuar në shtypin Tuaj ditore "KOHA" me datë 12.10.2018 (e premte).

Korrigjim:

Për Vendin e shpallur të punës në nr. rendor 2 – Biokimist – ALP kandidatët e paraqitur do të nënshtrohen dhënies së provimit - pjesa profesionale (Testim).

Për vendin e punës me nr. rendor 3. Radiolog Teknolog – ALP kandidatët e paraqitur do të nënshtrohen dhënies së provimit - pjesa profesionale (Testim) dhe testim për njohjen e një gjuhe të huaj.

IPSH Spitali Klinik Tetovë
Drejtori,
Doc. Dr Florin Besimi

**Shesim tokë ndërtimi - 9000m2
Në Komunën kadastrale Zllokuqani, në afërsi të vendit të paraparë për ndërtimin
e Qendrës së re klinike, shesim tokë ndërtimi me sipërfaqe prej 9.000 m2.
Tel. 071/372-215 & 078/243-583**



KOMUNA E BUTELIT
Nr. 09-1126/6 nga 31.10.2018
Shkup

Në bazë të nenit 35, ndërsa në lidhje me nenin 51 nga Ligji për planifikim urbanistik dhe hapësina (Gazeta zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016 163/2016 dhe 64/18), Kryetari i Komunës së Butelit e publikon këtë:

NJOFTIM

Njoftohen banorët dhe personat juridik që Kryetari i Komunës Butel ka sjell Vendim për organizimin e:

PREZANTIM PUBLIK DHE ANKETË PUBLIKE

për projektin Arkitektonik-urbanistik për formimin e komplot ndërtimit nga PK 1040/1 dhe pjesë nga PK 1040/3, me qëllim G4 - depo për shitje të materialit ndërtimor në Bllokun 5 nga PUJVB për zonën industriale Vizbeg me përpunim të Bllokut 12, KK Vizbeg, komuna Butel.

Hapësira që përfshin projekti Arkitektonik-urbanistik për formimin e komplot ndërtimit nga PK 1040/1 dhe pjesë nga PK 1040/3, me qëllim G4 - depo për shitje të materialit ndërtimor në Bllokun 5 nga PUJVB për zonën industriale Vizbeg me përpunim të Bllokut 12, KK Vizbeg, komuna Butel, është me sipërfaqe prej 2144,09 m².

Projekti Arkitektonik-urbanistik i përpunuar me bashkëngjitjet grafike do të ekspozohet në një vend publik në hapësirat e Komunës së Butelit në sallën për takime (salla e vogël).

Anketa publike do të mbahet nga 07.11.2018 deri 13.11.2018 (pesë ditë pune), çdo ditë pune nga ora 08.30 deri 15.30 në hapësirat e Komunës së Butelit në sallën për takime (salla e vogël).

Në afatin e përcaktuar personat fizik dhe juridik të interesuar mund të parashtrojnë vërejtje në fletat anketuese në formë elektronike ose përmes sistemit informativ e-urbanizëm ose në formë shkrimi.

Fletat anketuese për pjesëmarrje në anketën Publike mund të tërhiqen në Komunën e Butelit (sportel).

Njoftimi për organizimin e anketës publike do të publikohet në mediat e informimit, në sistemin informativ e-urbanizëm dhe në ueb faqen e Komunës së Butelit.

Prezantimi publik për projektin Arkitektonik-urbanistik për formimin e komplot ndërtimit nga PK 1040/1 dhe pjesë nga PK 1040/3, me qëllim G4 - depo për shitje të materialit ndërtimor në Bllokun 5 nga PUJVB për zonën industriale Vizbeg me përpunim të Bllokut 12, KK Vizbeg, komuna e Butelit, do të mbahet në hapësirat e Komunës së Butelit, në sallën për takime (salla e vogël), më datë 08.11.2018, me fillim prej orës 10:00.

KRYETARI
Velimir Smilevski

Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësina të Republikës së Maqedonisë

SHPALL

Kërkesë për dhënie e Lejes për shfrytëzimin e ujit nga pusi edhe atë prej nevoja teknologjike për larjen e rërës, zhavorrit dhe gurit edhe atë në PK 2619/8 KK Negorci, Komuna e Gjevgjelijë. Në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 nga Ligji i ujërave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14 dhe 146/15), deri te Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësina të Republikës së Maqedonisë, është dorëzuar Kërkesë për dhënie e Lejes për shfrytëzimin e ujit nga pusi për nevojat teknologjike për larjen e rërës, zhavorrit dhe gurit, me PA1 nr. 11/5-245/2018.

Parashtues i kërkesës:

Euro Ing

rr. Novalokacija Blokotehna nr. 16, komuna e Gjevgjelijë.

Koordinatat sipas sistemit nacional koordinativ:

X=4 559625, Y=7626234 sasia e zënies së ujit është 5 l/s

Informata në lidhje me kërkesën, opinionin i interesuar mund të marrë në Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësina të Republikës së Maqedonisë në e-mail adresën: k.zekiri@moepp.gov.mk

Opinionin i përfshirë, në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të kërkesës, ka të drejtë të parashtrojë mendime dhe komente në formë me shkrim deri në Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësina të Republikës së Maqedonisë, rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup.

TË GJITHË TRAJNERËT E FLORENTINO PEREZ

Është e njohur performanca e secilit trajner, që zgjodhi Florentino Perez për stolin e Real Madridit. Por çfarë ndodhi me ta, kur u larguan nga drejtimi i ekipit të bardhë? Mësojeni më poshtë, emër për emër



• Vicente del Bosque (1999-2003)



• Carlos Queiroz (2003-2004)



• José Antonio Camacho (2004-2004)



• Mariano García Remón (2004-2004)



• Vanderlei Luxemburgo (2004-2005)



• Juan Ramón López Caro (2005-2006)

Vicente del Bosque (1999-2003) – në pension - Kur Florentino Pérez fitoi zgjedhjet si president, Vicente del Bosque ishte tashmë "pronar" i stolit të Real Madridit. Me skuadrën e bardhë, ai fitoi një Kupë Europiane dhe dy tituj të La Liga-s. Interesant është fakti se ai u hoq nga detyra pasi fitoi titullin kampion në Spanjë. Del Bosque është larguar tashmë nga trajningu, pasi drejtoi kombëtaren spanjolle në Kupën e Botës 2010, në Afrikën e Jugut.

Carlos Queiroz (2003-2004) – trajneri i Iranit - Zëvendësuesi i Del Bosque ishte i (pa)njohuri (zv.trajner te Manchester United), Carlos Queiroz. Trajneri portugez qëndroi vetëm një sezon në "Santiago Bernabeu", sepse u shkarkua pas një fundi të tmerrshëm të vitit, që dënoi ekipin. Pas largimit nga ekipi i bardhë, Queiroz mori në dorë frenat e ekipit kombëtar portugez, pa arritur ndonjë sukses të lavdërueshëm. Që nga viti 2011, ai është trajner i Iranit.

José Antonio Camacho (2004-2004) – pa ekip - Pas zhgënjimit të madh, që pati Real Madridi me trajnerin Carlos Queiroz, presidenti Florentino Perez vendosi të punësojë një "krevat portativ" në Madrid: Jose Antonio Camacho. Pas vetëm tri javëve kampionat, trajneri spanjoll njoftoi dorëheqjen për shkak të mosmarrëveshjeve me politikën e ekipit të bardhë. Pas largimit nga kryeqyteti i Spanjës, ai nënshkroi për Benfikën, në atë që do të ishte faza e tij e dytë në Lisbonë. Më vonë mori frenat e drejtimit të Osasunës, derisa zgjodhi ekipet kombëtare. Kina ishte destinacioni i tij i parë në këtë drejtim dhe Gaboni i fundit (u largua vetëm një muaj më parë).

Mariano García Remón (2004-2004) – pa ekip - García Remón, një tjetër "madridist", mori përsipër drejtimin e "Los Blancos" nga Camacho, por qëndroi vetëm tre muaj. Ai që ishte portieri i kombëtares dhe Real Madridit do të nënshkruante tri vite më vonë me Cadiz, ekip në të cilin do të kishte përvojën e fundit si trajner.

Vanderlei Luxemburgo (2004-2005) – pa ekip - Zgjidhja për krizën në Madrid u kërkuar në Bra-

zil. Veçanërisht te Vanderlei Luxemburgo. Muajt e parë të punës i dhanë atij mundësinë për të filluar edhe sezonin e ardhshëm, por përfundoi duke u shkarkuar në dhjetor, për shkak të rezultateve të dobëta. Luxemburgo u kthye në Brazil, ku udhëhoqi skuadrat kryesore të vendit (Santos, Palmeiras, Flamengo, Fluminense...), edhe pse aktualisht është pa ekip.

Juan Ramón López Caro (2005-2006) – Shenzhen Football - Lopez Caro ishte trajner i shtëpisë, i zgjedhur për të drejtuar ekipin pas lamtumirës së Luxemburgo. Në asnjë moment me të, ekipi nuk bëri përpara, por e përkeqësoi krizën. Florentino Pérez do të jepte dorëheqjen si president. Pas largimit nga Real Madridi, Lopez Caro filloi një karrierë të gjerë, duke trajnuar ekipe të para si Racing, Levante apo Celta. Pas largimit nga Vigo, ai u bë trajner i U-21 për dy vite. Më tej kaloi të trajnonte në Arabinë Saudite dhe Oman, por përfundoi edhe në ligën kineze. Konkretisht, te Shenzhen Football, ku aktualisht është trajner i parë.

Manuel Pellegrini (2009-2010) – West Ham United - Florentino Pérez filloi, tre sezone më vonë, periudhën e dytë si president i Real Madridit. Dhe e nisi me Manuel Pellegrini në stol. Paraqitja e keqe në Ligën e Kampionëve determinoi largimin e trajnerit në fjalë në fund të sezonit. Kilieni do të nënshkruante për Malaga sezonin e ardhshëm, ku do të qëndronte tri vite. Pellegrini nënshkroi me Manchester City e fuqishëm financiar dhe fitoi Premier League. Destinacioni i tij i ardhshëm ishte Hubei Fortune i Kinës dhe aktualisht është trajner i West Ham United.

José Mourinho (2010-2013) – Manchester United - Një tjetër sezon pa tituj bëri që Florentino Perez të nënshkruante me José Mourinhon. Portugezi erdhi si idhull, pasi fitoi Ligën e Kampionëve me Interin. Në sezonin e tij të parë në "Santiago Bernabeu" fitoi La Ligan, në të dytin Kupën e Mbretit, por kurrë nuk arriti të kalojë gjysmëfinalen e Champions-it. Ky fakt dhe përkeqësimi i madh i marrëdhënieve të tij me lojtarët çoi në largimin e "Special One". Premier League ishte duke e pritur Mourinhon

me dyert e hapura. Ai është aktualisht trajner i Manchester United, pasi fitoi një tjetër titull në Premier League me Chelsea.

Carlo Ancelotti (2013-2015) – Napoli - Ancelotti u zgjodh si trajner nga Perez për të rifituar Ligën e Kampionëve. Tha dhe e bëri. Në vitin e tij të parë në stolin e "Los Blancos", tekniku italian fitoi "Decima"-n e shumë dëshiruar. Sezioni i dytë shkoi keq dhe e detyroi të largohej nga stoli i ekipit të bardhë. Pas një viti pushim, "Carletto" nënshkroi me Bayern Munich, ku qëndroi për një sezon. Napoli e ka nisur këtë sezon me të në stol.


Rafa Benítez (2015-2016) – Newcastle - Real Madridi i besoi dhe e shkarkoi pas një fillimi të keq të sezonit. Reputacioni i tij i mirë në Angli bëri që Newcastle ta thërrasë "nën armë" për të mbijetuar në Premier League. Ekipi në fjalë anglez përfundoi duke rënë një kategori më poshtë, por vetëm një vit më vonë do të kthehej në Premier League me ndihmën e spanjollit. Aktualisht, Benitez është ende trajner i "magpies".

Zinedine Zidane (2016-2018) – pa ekip - Ai erdhi për të mbushur boshllëkun e lënë nga Benítez dhe u bë trajneri më i mirë në historinë e ekipit të bardhë. Në tri vite si trajner i parë fitoi tre Champions, ndër të tjera. Një vendim personal e bëri të largohej nga timoni i drejtimit të Real Madridit në fund të sezonit të kaluar. Aktualisht, francezi nuk ka ekip nën drejtim.


Julen Lopetegui (2018-2018) – pa ekip - Ish-trajneri i Spanjës u pa si zëvendësuesi ideal i Zinedine Zidane nga presidenti Florentino Perez. Negocioi dhe arriti akord me Lopetegui sa ishte në stolin e "La Roja". Kjo gjë u mor vesh nga presidenti i Federatës Spanjolle të Futbollit, i cili nuk e kapërdiu dot "tradhtinë" e trajnerit, duke e shkarkuar një ditë para fillimit të Botërorit të Rusisë. Lopetegui e nisi mirë në ndeshjet e para të këtij sezoni, por më tej është e njohur kriza rezultateve e Real Madridit. Me humbjen turpëruese 5-1 në "El Clásico", fundjavën e kaluar, u mbush edhe kupa. Presidenti Perez vendosi ta shkarkojë Lopetegui, që tani është pa ekip.




• Manuel Pellegrini (2009-2010)




• José Mourinho (2010-2013)




• Carlo Ancelotti (2013-2015)



• Rafa Benítez (2015-2016)



• Zinedine Zidane (2016-2018)



• Julen Lopetegui (2018-2018)



1 VIT BURG PËR KIRURGUN QË E KTHEU MODELEN NË "PËRBINDËSH"

cilat më kushtuan 93 mijë euro dhe nuk kam marrë as edhe një kompensim". Kështu ka rrëfyer Cristina Guidetti, një ish-modelle modeneze që ka folur pas dënimit në shkallë të parë me një vit burg (dënim me kusht) të kirurgut që e operoi atë, por në të vërtetë e shpërftyroi.

"A ju duket kjo drejtësi? Mjeku që më ka operuar më 31 janar 2012, Massimo Rambot-

ti, 62 vjeç, u dënua me një vit burg me dënim të pezulluar. Kirurg i zakonshëm i Foligno, kreu operacionin në një klinikë private në Padova, një trajtim me lazer për të hequr disa papërsosmëri të vogla siç kërkohet nga unë dhe ranë dakord me mjekun. U besova, mjeku ishte ndër më të respektuarit", shprehet gruaja. Gjyqtari i Padovës e ka shpallur kirurgun fajtor për lëndime shumë të rënda, por gjyqi vazhdon.

Pas këtij operacioni "unë u shpërftyrova" dhe madje edhe sot unë "në fytyrën time kam plagë që do të mbeten përgjithmonë, përkundër 42 trajtimeve të mëvonshme, të



Vajza që pretendon se fjeti me 20 fantazma, martohet me njërin prej tyre

Vajza britanike që çuditi publikun pak kohë më parë duke thënë se kishte fjetur me rreth 20 fantazma, pasi meshkujt e gjallë nuk i hynin më në sy, tani thotë që njëri prej tyre i ka propozuar për martesë.

Ajo thotë se fantazma që e propozoi quhet Ray, dhe është shumë e lumtur për vendimin. Madje, ka dëshirë t'i flasë edhe për fëmijë, por druan se mos është pak herët, se mos e tremb me këto biseda. Vajza që quhet Amthyst Realm shpjegon herën e parë që ishte vizituar nga një fantazmë, pasi pranon që është e vështirë ta kuptojnë. Por ajo thotë që kontaktet fizike i ndien, edhe pse nuk i sheh. Lidhja e parë kishte ndodhur kur ishte shpërngulur me ish të fejuarin në një shtëpi të re, 12 vite më parë. Aty ndjeu praninë. "Nisi si energji. Ndieja shtypjen e tij mbi trupin tim dhe frymën në qafë, por nuk e shihja", shpjegon ajo.

Njihuni me burri që ka mustaqet më të gjata në botë



Ky burrë quhet Girdhar Vyas dhe krenohet me një rekord të pazakontë: mustaqet e tija më të mëdha në bote. 58-vjeçari, me origjinë nga Bikaner, e Indisë ka nisur që t'i rrisë mustaqet që nga viti 1985 dhe sot ai fitoi rekordin sepse mustaqet e tij janë 7 metra të gjatë. Çdo ditë Girdhar i kushton deri tre orë trajtimin të mustaqeve të tij.



Google merr miratimin për makinat pa shofer

Waymo, divizioni i makinave pa shofer i kompanisë Google, mori licencën e parë për të testuar makina pa shofer në rrugët e Kalifornisë, theksoi shtypi vendas. Për momentin, 60 kompani lejohen të provojnë makina autonome në rrugë, por Waymo është e para kompani që e merr atë për të testuar makinat pa shoferin e sigurisë. "Kalifornia ka punuar për vite me radhë dhe do të vazhdojë të ketë siguri publike në një linjë me zhvillimin e kësaj teknologjie", tha numri një i Departamentit të Transportit në Kaliforni, Jean Shiomoto. Licenca lejon mundësinë e kryerjes së testeve dhe makinat e para pa shofer do të rezervohen për punonjësit e Waymo-s.



1772 - Boston: Formohet Komiteti anti anglez i Korrespondencës.

1811 - Beteja e Tippecanoe: Gjen. Jackson kundër indianëve.

1841 - Akbar Khan në mënyrë të suksesshme revoltohet kundër Shah Shuxha në Afganistan.

1851 - Louis Napoleon merr fuqinë në Francë.

1904 - Fillon botimi i gazetës britanike "Daily Mirror".

1914 - Britania e Madhe përfiton Qipron.

1914 - Rusia i shpall luftë Turqisë.

1917 - Deklarata e Balfour shpall mbështetje për krijimin e shtetit hebre në Palestinë.

1953 - Pakistani bëhet shtet islamik.

1964 - Faisal trashëgon Saudin si mbret i Arabisë Saudite.

1993 - Rudolph Guliani (R) zgjedhet kryetar i Nju Jork Shtetit.



EKSPOZITA E ZHVESHUR

Në Medellin, Kolumbi, dhjetëra persona kanë vizituar një ekspozitë të zhveshur. Ekzibicioni, i titulluar 'nudo, tregon lirinë', përfshinte 120 piktura nudo të Pedro Nel Gomez, piktori kolumbian shumë i njohur në mes të viteve 900'. "Për mua Pedro Nel Gomez ka qenë artisti i parë që ka trajtuar nudizmin hapur dhe për këtë u censuruar dhe u kritikua. Ajo që bëjmë ne sot është një mënyrë për të njohur se si ai e shihte nudizmin, si një gjë natyrale", ka shpjeguar një nga pjesëmarrësit, Leonardo Patino. Kjo vizitë e veçantë është organizuar nga një shoqatë nudistësh të qytetit, që në dy vjet ka bashkuar 800 persona.

PEZULLIM NGA SHKOLLA

Mësuesja: Pse qesh?

Nxënësi: Pash një rrip të sutjenave tua!

Mësuesja: Dil jashtme, 1 muaj pezullim!

Qesh nxënësi i dytë

Mësuesja: Po ti, pse qesh?


Nxënësi: Pash dy rripat e sutjenave tua!

mësuesja: Dil jashtme, dy muaj pezullim!

Mësuesja ulet të marrë shkumësin në tokë, dhe Beni fillon të dal nga klasa.

Mësuesja: Beni ku shkon ti?

Beni: Me atë që pash kur u ule të merrje shkumësin, për mua u mbyll shkolla!



Është shumë e vështirë të diskutosh në mbretërinë e idiotëve.

(Ismail Kadare)